



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 320 Akti

Nr. 489 Vendimi
Tiranë, më 16.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 15.12.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Binas Nina, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

Pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Subjekti i rivlerësimit Binas Nina, me funksionin prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit ex officio, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurave të shpërndarjes së çështjeve me short në datën 12.11.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Binas Nina, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 2, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari, relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Lulzim Hamitaj.
3. Në mbledhjen e trupit gjyqësor të datës 19.11.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Binas Nina.
4. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Binas Nina, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
5. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr.84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
6. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
7. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

8. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Në respektim të procedurave ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ka vijuar me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrinin nivelin e provueshmërisë dhe në datën 21.10.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, bazuar në tre kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Binas Nina; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Po në datën 25.10.2021, subjektit të rivlerësimit iu komunikuan rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni, si dhe u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte depozitimin e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, duke i caktuar afatin 14-ditor për marrjen e aksesit në dosjen e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes dhe as nuk paraqiti parashtrime dhe/apo prova të reja lidhur me rezultatet e hetimit administrativ në datën 28.10.2021, duke marrë një kopje të dokumenteve të dosjes, në formatin elektronik.
11. Me e-mail-in e datës 1.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shtyrje të afatit për përgjigjet e tij, përcaktuar për në datën 8.11.2021 nga Komisioni, pasi e ka pasur të pamundur marrjen e disa dokumenteve, të cilat kryesisht kishin të bënin me të ardhurat e vëllait, i cili ka dërguar edhe një e-mail për të informuar mbi pamundësinë e tij për dërgimin e dokumentacionit provues në datën e përcaktuar nga Komisioni. Me vendimin nr. 3, Komisioni vendosi pranimin e kërkesës së subjektit për zgjatjen e afatit të dërgimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit mbështetës për një javë. Gjithashtu, më 16.11.2021, subjekti nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar edhe thirrjen për dëgjues të 10 dëshmitarëve, duke parashtruar emrat dhe gjenaralitetet e tyre në kërkesën e bashkëlidhur prapësimeve.
12. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 16.11.2021, ka vendosur "mospranimin e kërkesës së subjektit për thirrjen e 10 dëshmitarëve në bazë të pikës 1, të nenit 49, të ligjit 84/2016, duke mbajtur në konsideratë faktet, rrethanat dhe dokumentacionin e disponuar, ka vlerësuar se të gjithë personat e listuar që ka cituar subjekti dëshmitarë në listën e depozituar, kanë kryer më herët një deklaram para noterit dhe se të gjitha këto deklarata janë paraqitur prej tij dhe janë pjesë e dosjes së administruar nga Komisioni, të cilat do të shqyrtohen/vlerësohen lidhur me rrethanat përkatëse. Gjithashtu, me vendimin nr. 5, datë

17.11.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin Binas Nina në seancën dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, datë 22.11.2021 ora 10:00.

13. Më tej, në datën 22.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një raport mjekësor, pasi ka rezultuar pozitiv me COVID -19, që nuk i mundësonte pjesëmarrjen në seancë. Në këto kushte, trupi gjykues me vendimin nr. 6, të po kësaj datë, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit për shkaqe shëndetësore, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e seancës dëgjimore, pikërisht më 6.12.2021, ora 9:30. Në datën 6.12.2020, kur kishte përfunduar edhe afati i karantinimit për subjektin e rivlerësimit, subjekti kishte njoftuar nëpërmjet postës elektronike një kërkesë të re për shtyrje të seancës, pasi kishte pamundësi për t'u paraqitur. Kësaj kërkesë i ka bashkëlidhur edhe një tjetër raport mjekësor, nga ku rezultonte me paaftësi në punë deri në datën 12.12.2021. Ndërkohë, në padijeni të këtij njoftimi, Komisioni kishte zhvilluar seancën dëgjimore, ku ishin bërë me dije publikisht gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ.
14. Ndodhur në këto kushte dhe në vijim të një tjetër komunikimi me *e-mail* të subjektit, Komisioni në respektim të një procesi të rregullt ligjor, për t'i mundësuar subjektit mbrojtjen e tij, e njoftoi atë me anë të postës elektronike mbi vendimin nr. 7, datë 7.12.2021, të trupit gjykues, i cili është vendosur (me shumicë votash) zhvillimin e një tjetër seance dëgjimore më 15.12.2021, ora 12:30.
15. Gjithashtu, në datën 9.12.2021, Komisioni iu drejtua¹ Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke i kërkuar informacion lidhur me prezencën e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës kohore 19.11.2021 – 10.12.2021. Kjo e fundi, me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2021, ka bërë me dije se subjekti ka qenë në karantinë, shoqëruar kjo periudhë paaftësie me dokumentacionin përkatës nga Qendra Shëndetësore Nr. ***, Elbasan.
16. Në këto kushte, pas përfundimit të afatit të mësipërm, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar dhe të subjektit të rivlerësimit, në datë 15.12.2021, zhvilloi një seancë të dytë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Në datën e përcaktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit përveç prapësimeve paraqiti edhe dokumentacion tjetër mbështetës, që u administrua nga sekretaria gjyqësore, sipas procedurave përkatëse.
18. Seancat dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Binas Nina u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 6.12.2021 dhe 15.12.2021, në ambientet e Pallatit e Koncerteve në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në seancën dëgjimore. Në përfundim të relatimit të rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe pasi u dëgjua subjekti lidhur me çdo element që vlerësoi të shpjegonte, trupi gjykues njoftoi se seanca për shpalljen e vendimit do të zhvillohej në datën 16.12.2021, ora 9:30.

¹Komisioni iu drejtua edhe nëpërmjet postës elektronike, referuar *e-mail*-it të datës 13.12.2021, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Binas Nina ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke iu përgjigjur drejtpërdrejt të gjitha pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ, si edhe duke depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe me dërgimin e rezultateve të hetimit. Nisur nga fakti që subjekti ka paraqitur kërkesa të përsëritura për të marrë më shumë kohë dhe për shtyrje të afateve apo seancave të caktuara nga Komisioni, duke lënë përshtypjen e një tentative për zvarritje të procesit të rivlerësimit të tij, kjo rrethanë është mbajtur parasysht nga trupi gjykues.

IV. HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
21. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.
22. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; c) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

25. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
26. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikt interesi të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Apartament banimi, me sip. 106 m², Elbasan

27. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, apartament me sip. 100 m², në vlerën 4.000.000 lekë dhe me burim krijimi: (i) vlerën 2.000.000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit në datën 18.4.2001²; (ii) vlerën 1.900.000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit në datën 31.10.2003³; si dhe (iii) vlerën 100.000 lekë të ardhura nga paga.
28. Nga shqyrtimi i kontratës së sipërmarrjes⁴ të datës 18.10.2000, të nënshkruar mes subjektit të cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “****” sh.p.k.⁵ në cilësinë e sipërmarrësit⁶, ka rezultuar se palët kanë rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti me sip. 100 m², me çmim total 4.500.000 lekë, ku në nenin 2 të kësaj kontrate deklarohet se është likuiduar në dorë (*cash*) shuma 1.500.000 lekë dhe në nenin 3 të saj specifikohet se porositësi detyrohet që brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës të derdhë për llogari të sipërmarrësit shumën 750.000 lekë.
29. Gjithashtu, është konstatuar gjatë hetimit se pasuria është përfituar nëpërmjet finalizimit që është bërë në vitin 2012, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes⁷, datë 15.11.2012, me shoqërinë⁸ “****” sh.p.k., për apartamentin të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, kundrejt çmimit 4.300.000 lekë⁹.
30. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit që të paraqesë dokumentacionin për të provuar momentin dhe kohën e shlyerjes së kësteve, në përgjigje të së cilit subjekti është shprehur se deri në fund të vitit 2003 ka paguar shumën 4.000.000 lekë dhe

²Pasuria me nr. hipotekor *** dhe numër rendor ***, datë 4.8.1995.

³Pasuria me nr. hipotekor ***.

⁴Kontratë me nr. ***.

⁵Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2021, ka informuar se për subjektin “****” sh.p.k., si dhe për subjektin “****” sh.p.k. janë regjistruar disa materiale, për të cilat është vendosur mosfillimi dhe se asnjë nga këto procedime nuk është hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

⁶Përfaqësuar nga z. A.G.

⁷Kontratë nr. ***.

⁸Lidhur me ndryshimin e emërimit të shoqërisë nga “****”sh.p.k., në “****” sh.p.k., subjekti është shprehur se ka pasur marrëdhënie juridike me shtetasin A.G., i cili është paraqitur si sipërmarrës i shoqërisë “****” sh.p.k., në kontratën e sipërmarrjes dhe i shoqërisë “****” sh.p.k., në kontratën e shitjes. Ndërsa lidhur me ndryshimin e adresës ku njëherë është shënuar 28 dhe një herë 29 N***, subjekti ka sqaruar se kjo ka ardhur për shkak të rotacionit politik.

⁹Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2012, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pagesën prej 300.000 lekësh, për sipërfaqen shtesë prej 6 m² në apartamentin e banimit të deklaruar në vitin 2003.

se këstet dhe kohën e pagesës nuk i mban mend dhe nuk ka ruajtur dokumentacion, pasi ka kaluar një kohë e gjatë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nuk ka bërë asnjë ndërtim shtesë apo pakësim dhe asnjë pagesë shtesë dhe se në vitin 2012¹⁰ është ndodhur përpara faktit që sipërfaqja e apartamentit nuk ishte 100 m², sipas kontratës së sipërmarrjes, por 106 m². Nisur nga sa më sipër dhe, për këtë shkak, kishte rënë dakord me subjektin ndërtues që të paguante edhe diferencën e çmimit në vlerën 300.000 lekë për sipërfaqen prej 6 m², vlerë të cilën e ka deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2012.

31. Lidhur me diferencën midis çmimit në kontratën e sipërmarrjes në vlerën 4.500.000 lekë dhe çmimit të blerjes të përshkruar në kontratën e shitjes së vitit 2012, në vlerën 4.300.000 lekë, subjekti ka sqaruar se është bërë në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, sipas nenit 5 të kësaj kontrate dhe i është ulur nga shoqëria ndërtuese vlera 5% e blerjes dhe kjo ka bërë që vlera e apartamentit nga 4.500.000 lekë të shkojë në 4.300.000 lekë.
32. Së bashku me përgjigjet e mësipërme të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur shkresë me nr. *** prot., datë 9.8.2021, nga ASHK-ja Elbasan, si dhe dokumentacionin në bazë të të cilit është kryer regjistrimi i pasurisë¹¹.
33. Komisioni, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore, është konsultuar me udhëzimin nr. ***, datë 14.7.2000, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, nga ku ka rezultuar se çmimi mesatar i tregut të lirë në vitin 2000, për qytetin e Elbasanit, ka qenë 44.790 lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi, e cila përputhet me çmimin/m² të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes prej 45.000 lekë. Sipas këtij çmimi/m² të rënë dakord mes palëve në vitin 2000, për apartamentin e përfutur efektivisht nga subjekti i rivlerësimit, me një sipërfaqe totale prej 113.8 m², do të rezultonte një çmim prej 5.121.000 lekësh.

1.1 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

34. ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2020, ka konfirmuar pasurinë e llojit apartament me sip. 106 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në z. k. ***, në pronësi¹² të subjektit, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës¹³, si dhe certifikatën për vërtetimin e pronësisë, datë 9.11.2012, nga ZVRPP-ja Elbasan.
35. Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 18.10.2000, nënshkruar mes shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. për ndërtimin e apartamentit me sip. 100 m², kundrejt vlerës prej 4.500.000 lekësh. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.11.2012¹⁴, për shitjen e pasurisë së lidhur mes subjektit të

¹⁰Vit në të cilin është regjistruar pasuria.

¹¹Nga dokumentacioni i paraqitur ka rezultuar se fillimisht me vendim nr. ***, datë 12.7.2000, të KRRT-së Elbasan ishte miratuar *Leja e ndërtimit për objektin pallat 8 kat+bodrum për trashëgimtarët e z. I.Q. subjektit ndërtues “****”*. Më pas, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2011, të KRRT-së Elbasan është miratuar saktësimi i planvendosjes dhe projektit, si dhe rikondicionimi i objektit “pallat 8 kat” në “godinë banimi kolektive 1 kat podrum + 1 kat lokal + 7 kat banim + 1 kat me sipërfaqe të reduktuar”, me investitor z. A.G.

¹²Gjithashtu, nga kontrolli i sistemit *online* të ASHK-së Elbasan, konfirmohet pasuria në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

¹³Në kontratën e shitjes, rezulton të këtë koment nga regjistruesi se në seksionin e hipotekave se me urdhrin nr. ***, datë 9.11.2012, është regjistruar padia. Subjekti së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka vënë në dispozicion vendimin për sigurimin e padisë, nr. ***, datë 19.11.2012, duke vendosur pezullimin e veprimeve për regjistrimin në ZVRPP-së Elbasan, të ndërtimit mbi pasurinë *** që ndodhet në z. k. ***, në lagjen “****”, në pronësi të shtetasit A.G., kërkesë e rrëzuar nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, si e pabazuar në ligj e në prova.

¹⁴Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, me shkresën Nr. *** Prot, datë 06.05.2021, ka konfirmuar veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur duke filluar nga data 01.03.2013 deri në datën 05.05.2021, periudhë kjo pas kryerjes së veprimeve të mësipërme.

rivlerësimit e bashkëshortes dhe palës shitëse A.G., i përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shoqëria “****” sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori i saj¹⁵, kundrejt çmimit total 4.300.000 lekë.

36. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nuk kanë rezultuar kontrata për furnizim.
37. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2021, ka bërë me dije se nga të dhënat e sistemit të faturimit ka rezultuar 1 abonent me kontratë furnizimi Nr. *** në qytetin e Elbasanit, në emër të shtetasit Binas Nina, me adresë afër Pallatit të Sportit¹⁶.

1.2 Lidhur me burimet e krijimit për blerjen e kësaj pasurie

38. Nga shqyrtim i DIPP-së të vitit 2003, konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament me vlerë 4.000.000 lekë me burim krijimi të përfituar nga transaksionet: (i) shuma 2.000.000 lekë nga shitja e apartamentit në datën 18.4.2001¹⁷; (ii) shuma 1.900.000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit në datën 31.10.2003¹⁸; si dhe (iii) shuma 100.000 lekë nga të ardhurat nga paga.
39. Ndërkohë në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar vlerën totale 4.300.000 lekë, duke konfirmuar të njëjtat burime të krijimit për shumën 4.000.000 lekë, të paguar në vitin 2003, ndërsa lidhur me burimin e krijimit të shumës 300.000 lekë, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vitin 2012.
40. Referuar deklaratimit të subjektit se deri në fund të vitit 2003 ka paguar shumën 4.000.000 lekë dhe se këstet, kohën e pagesës nuk i mban mend e nuk ka ruajtur dokumentacion, Komisioni ka konsideruar shlyerjen e shumës sipas përcaktimeve në kontratën e sipërmarrjes të datës 18.10.2000, ku çmimi total rezulton të jetë në vlerën 4.500.000 lekë, nga të cilat: (i) shuma 1.500.000 lekë janë deklaruar të shlyera jashtë zyrës noteriale në kontratën e sipërmarrjes; (ii) shuma 750.000 lekë do të likuidohen pas 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës; (iii) 40% të vlerës totale do të likuidohen me dorëzimin përfundimtar, nga ku referuar deklaratimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka filluar të banojë që prej vitit 2001, në apartamentin objekt i kësaj analize.

1.3 Lidhur me pagesën e këstit të parë dhe të dytë

41. Komisioni mori në analizë pagesën e parë në vlerën 1.500.000 lekë, të kryer maksimalisht në datën 18.10.2000 dhe pagesën e dytë prej 750.000 lekësh, të kryer të paktën deri në datën 18.11.2000,¹⁹ nga ku konstatohet se të ardhurat e deklaruara si të përdorura kanë qenë të përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan²⁰, me kontratën e

¹⁵Bashkëlidhur praktikës nr.***, datë 4.3.2020, të ardhur nga ASHK-ja Elbasan, ndodhet edhe prokura e posaçme nr. ***, datë 15.11.2012, ku shtetasit A.G. dhe A.G. (bashkëshortja), kanë emëruar si përfaqësues shoqërinë “****” sh.p.k., për nënshkrimin e kontratave të shitjes të pasurive të regjistruara në z. k. ***, ku z. A.G. është investitor dhe pronar truall.

¹⁶Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar vendbanimet e tij përgjatë detyrës, ku adresa aktuale prej vitit 2001 është pallati i ri, pranë Pallatit të Sportit Elbasan, lagja “****”, Elbasan.

¹⁷Pasuria me nr. hipotekor *** dhe numër rendor ***, datë 4.8.1995.

¹⁸Pasuria me nr. hipotekor ***.

¹⁹Referuar gjithmonë përcaktimeve në kontratën e sipërmarrjes, në mungesë të ndonjë dokumentacioni të kohës për të provuar mënyrën dhe kohën e pagesës

²⁰Kjo pasuri është blerë më herët me kontratën nr. ***, datë 2.8.1995, nga pala shitëse P.S. dhe M.S., kundrejt çmimit 520.000 lekë.

shitblerjes nr. ***, datë 18.4.2001²¹, dhe, për pasojë, arrihet në konkluzionin se ato nuk mund të përdoreshin si burim krijimi për blerjen e pasurisë në analizë, për sa kohë kontrata e shitblerjes së apartamentit në lagjen “***” daton rreth 6 muaj pas kryerjes së pagesave të lartpërmendura.

42. Lidhur me mospërputhjen e periudhës midis pagesave të kryera dhe përfitimit të të ardhurave nga shitja, është pyetur nga Komisioni subjekti, i cili në përgjigjet e tij ka shpjeguar se: *“Para se të lidhej kontrata e sipërmarrjes me shtetasin A.G., kisha nxjerrë shtëpinë në shitje, blerjen e ka bërë shtetasja N.D., e cila banonte në të njëjtin fshat L***-F***, ku kishte banuar F.N.. Për shkak të njohjes dhe marrëdhënieve familjare, në muajin tetor vitit 2000 N.D. do të paguante shumën 1.500.000 lekë nga çmimi total i shitjes, pasi nuk i kishte të gjitha paratë për shumën e plotë. Binas Nina ka kërkuar vlerën 1.500.000 lekë, pasi do e paguante si këst për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes... Në momentin e porositjes së kontratës së sipërmarrjes, fillimisht kjo shtetase, jashtë sistemit bankar, na dha shumën 1.500.000 lekë dhe ramë dakord që shuma tjetër 450.000 lekë, të na jepej pas disa ditësh dhe kur të bëhej likuidimi i plotë i shumës, të bëhej kontrata e shitblerjes. ..Për shkak të marrëdhënieve shoqërore me bashkëshorten time, pranua vonesën... Në momentin që kjo shtetase pagoi jashtë sistemit bankar edhe shumën 450.000 lekë, më 18. 4.2001, bëmë kontratën e shitblerjes”.*
43. Për të provuar sa më sipër është përshkruar, subjekti vuri në dispozicion deklaratën noteriale²², datë 8.8.2021, të shtetases N. D., e cila ka deklaruar, ndër të tjera, se për shkak të lidhjeve shoqërore që ka pasur me bashkëshorten e subjektit, ka parapaguar shumën 1.500.000 lekë si pjesë e çmimit të blerjes dhe se diferenca e çmimit prej 450.000 lekë, do të likuidohej më vonë, me nënshkrimin e kontratës.
44. Lidhur të ardhurat e pretenduara si të marra/disponuara në tetor të vitit 2000 nga kontrata e shitblerjes, ndërkohë që kjo kontratë është nënshkruar në muajin prill 2001, Komisioni në mungesë të një prove/dokumenti të kohës për kryerjen e parapagimit, nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, pasi deklaratat e mëpasshme të palëve nuk mund të zhbëjnë atë çka është shprehur përpara noterit në një kontratë shitblerje, e cila për më tepër është regjistruar në organet kompetente dhe i ka prodhuar efektet e saj reale në vitin 2001, pasi përmbajtja e kontratës së shitblerjes prevalon mbi çdo deklaram apo pretendim ndryshe, për sa kohë në të nuk është cituar asgjë lidhur me pagesën e çmimit më herët.
45. Për rrjedhojë nga sa më lart është përshkruar, Komisioni ka përllogaritur si burim për kryerjen e pagesave të këstit të parë dhe të dytë në shumën totale 2.250.000 lekë, vetëm të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe të bashkëshortes, përgjatë periudhës²³ shtator 1995 – nëntor 2000.
46. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se përgjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit ka blerë një pasuri të paluajtshme të llojit *truall* të ndodhur në lagjen

²¹Subjekti ka vënë në dispozicion mandatarëkimin e datës 19.4.2001, për kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, referuar kontratës nr. ***, në masën 0.5 %, të vlerës prej 1.950.000 lekësh, të arkëtuar pranë ZVRPP-së Elbasan.

²²Deklaratë noteriale me nr. ***.

²³Komisioni ka kryer analizën duke filluar nga shtatori i vitit 1995, për sa kohë në gusht të vitit 1995, ka rezultuar se subjekti ka kryer një investim në shumën 520.000 lekë, për blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “***”, pall. ***, sh. ***, nr. ***, Elbasan, me kontratën nr. ***, datë 2.8.1995, për të cilin nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat nga pagat të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën 426.001 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni ka nisur analizën financiare pas këtij investimi.

“***”, Elbasan, me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, me sip. 41.3 m², nga të cilat 18 m² sipërfaqe ndërtese. Kjo pasuri është përfutur nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.5.2000, nga pala shitëse M.C.²⁴, kundrejt shumës prej 500.000 lekë²⁵, investim ky i cili është përfshirë në analizën e financiare.

47. Referuar deklaramit të subjektit në DIPP-në e të vitit 2003, ka rezultuar se bashkëshortja ka depozituar në vitin 2000, shumën 500.000 lekë, në depozitë me afat anë Bankën e Kursimeve Elbasan. Në mungesë të një dokumentacioni për të provuar datën e saktë të investimit, përpara apo pas kryerjes së pagesave në fjalë, kjo pasuri është trajtuar veçmas dhe nuk është përfshirë në analizën në fjalë.
48. Në përfundim të sa më sipër, pas përlogaritjes nga Komisioni dhe të shpenzimeve jetike të familjes së subjektit, përgjatë të njëjtës periudhë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 1.662.740 lekë, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1- Analiza e burimeve financiare për pagesën e kështit të parë dhe të dytë

Të ardhura nga pagat shtator 1995 - nëntor 2000		2 022 435
Shpenzime jetese shtator 1995 - nëntor 2000	-	935 176
Shpenzim për blerje apartamenti maj 2000	-	500 000
Pagesa e kështit I - tetor 2000	-	1 500 000
Pagesa e kështit II - nëntor 2000	-	750 000
Rezultati	-	1 662 740

1.4 Lidhur me pagesën e kështit të tretë

49. Në kontratën e sipërmarrjes të apartamentit në analizë, si dhe të deklarimeve të subjektit, diferenca në shumën prej 1.750.000 lekësh²⁶ duhet të jetë likuiduar nga subjekti në momentin e dorëzimit të apartamentit, nga ku referuar përmbajtjes së kontratës së shitblerjes²⁷, apartamenti në analizë do të lirohej së paku në datën 30.9.2001.

²⁴Nga dokumentacioni i disponuar, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ngritur një kërkesëpadi, me objekt detyrimin e ZVRPP-së Elbasan për regjistrimin e pronës në z. k. ***, nr. pasurie ***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 6.3.2003, të dhënë nga gjyqtari T. K. ka vendosur pranimin e kërkesës dhe detyrimin e ZVRPP-së për regjistrimin e pasurisë, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 21.3.2003.

²⁵Këtë pasuri subjekti ia ka shitur në vitin 2003, shtetases A.N. (nënës së tij), kundrejt çmimit 1.900.000 lekë. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të bënte me dije statusin juridik të kësaj pasurie dhe nëse gjatë periudhës në fjalë ishte përdorur nga ai apo dhënë më qira, si dhe lidhur me diferencën midis çmimit të blerjes nga ana e tij prej 500.000 lekë me çmimin e shitjes nënës së tij prej 1.900.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se: “Ndërtesa nuk është përdorur dhe nuk është dhënë me qira, diferenca e çmimit të blerjes me atë të shitjes vjen nga ndryshimi i çmimit të tregut, si dhe si një marrëdhënie mes palëve. E kam blerë këtë ndërtesë ‘të vesuar’ nga shitësi i saj dhe, për pasojë, më është dashur të ndjek disa procese gjyqësore për fitimin dhe regjistrimin e kësaj pasurie pranë ZVRPP-së Elbasan, sipas vendimit nr. ***, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pas regjistrimit të statusit juridik të pronës, ajo i është shitur nënës me çmimet e tregut. Kjo ndërtesë në atë kohë ka qene 1-katëshe dhe me mundësi zhvillimi, e në vitet në vijim ndërtesa është zhvilluar sipas lejes së ndërtimit. Aktualisht në këtë pronë përveç nënës, jeton edhe vëllai im A.N.”. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur mandatarëkimin nr. ***, datë 12.11.2003, ku pasqyrohet kryerja e pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë në shumën 9.750 lekë.

²⁶Pagesë e kështit të tretë për t’u plotësuar shuma prej 4.000.000 lekësh.

²⁷Kontratë nr. ***, datë 18.4.2001, kundrejt çmimit 1.950.000 lekë. Pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, lidhur me diferencën e çmimit të blerjes prej 520.000 lekësh të blerë në vitin 1995 dhe çmimit të shitjes në vitin 2001, prej 1.950.000 lekë, subjekti ka shpjeguar se ky ndryshim ka ardhur si pasojë e ndryshimit të çmimit të tregut.

50. Komisioni ka përllogaritur për këtë pagesë, të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga punësimet përkatëse, për periudhën dhjetor 2000 – tetor 2001, të cilat kanë rezultuar në masën 465.752 lekë. Përveç të ardhurave të përfituara nga pagat përkatëse, në këtë analizë janë përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në prill të vitit 2001, në shumën 1.950.000 lekë, si dhe janë përllogaritur shpenzimet e jetesës së familjes për të njëjtën periudhë, në përfundim të së cilës ka rezultuar se kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, si vijon:

Tabela nr. 2 - Analiza e burimeve për pagesën e kështit të tretë

Të ardhura nga pagat dhjetor 2000 - tetor 2001	465 752
Të ardhura nga shitja e apartamentit prill 2001	1 950 000
Shpenzime jetese dhjetor 2000 - tetor 2001	- 308 592
Pagesa e kështit III - tetor 2001	- 1 750 000
Rezultati	357 160

1.5 Lidhur më të ardhurat e përfituara nga kundërshtëpërblimi

51. Nga shqyrtimi i DIPP-në e vitit 2007, si dhe në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 1.000.0000 lekë, si kundërshtëpërblim nga shtetasi E.K., të përfituara nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.9.2007. Në këtë deklaratë shtetasi E.K.²⁸ së bashku me nënën L.K., kanë deklaruar se janë pronarë të një trualli të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, për të cilin kanë marrë leje ndërtimi për një pallat 8-katësh, përbri pallatit në të cilin banon subjekti i rivlerësimit. Meqenëse subjektit të rivlerësimit, i cili banon në katin e katërt të pallatit, me ndërtimin e pallatit të ri i shkaktohej dëm, palët kanë vendosur që ky i fundit të dëmshpërblehej në shumën 1.000.000 lekë, të dhënë *cash*. Gjithashtu, në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar se ka marrë shumën e sipërcituar dhe se ka hequr dorë nga e drejta e padisë për pengimin e shfuqizimin e aktit administrativ të dhënies së lejes së ndërtimit.
52. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se së bashku me shtetasin A.Ç.²⁹, i cili sipas shpjegimeve të subjektit është banor i pallatit, kanë depozituar një kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “anulimin e lejes së ndërtimit dhe marrjen e masës së sigurimit për ndërtimin e pallatit 8-katësh nga L.K.”. Me vendimin nr. ***, datë 13.9.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka vendosur “pushimin e gjykimit”, pasi subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga gjykimi, ndërsa paditësi tjetër A. Ç., nuk është paraqitur, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 17.9.2007.
53. Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, iu drejtua subjektit që të shpjegojë dinamikën e ngjarjes dhe të arsyeve të depozitimit të kërkesëpadisë, duke i kërkuar të paraqiste dokumentacionin ligjor që provonte ndërtimin e pallatit, si dhe pronësinë e truallit të shtetasit E.K. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se: “*Leja e ndërtimit ishte dhënë jashtë kushteve të përcaktuara në ligjet e urbanistikës, pasi ndërtimi do të afrohej afër dritareve dhe ballkonit të apartamentit tim ... Në këto kushte i jam drejtuar sipas ligjit, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

²⁸Nga dokumentacioni i depozituar certifikatë familjare, konstatohet se shtetasi E.K. është biri i shtetasës L.K., si dhe bashkëshorti i shtetasës V.K.

²⁹Nga kontrolli në sistemin *online* të ASHK-së, nuk ka rezultuar që shtetasi A.Ç. të ketë në pronësi apartament në të njëjtin pallat me subjektin e rivlerësimit e as ndonjë dokument të kohës që të vërtetojë këtë pronësi. Ai ka rezultuar pronar i një sipërfaqe 67.8 m², ku 32, të përfituar nga kontrata e datës 22.4.1992 nga Komiteti Ekzekutiv i Elbasanit, si dhe një apartament të ndodhur në lagjen “****”, të përfituar nga babai i tij me kontratën e datës 15.9.1993.

Elbasan, me kërkesë padi, gjatë gjykimit, shtetasi E.K. më kërkoi që të hiqja dorë nga padia dhe të më kompensonte dëmin e pësuar. Me marrëveshje midis palëve, ramë dakord që dëmi që ai do të kompensonte të ishte 1.000.000 lekë dhe të vazhdonte ndërtimin”.

54. Në mbështetje të sa më sipër shpjeguar, subjekti ka paraqitur dokumentacionin në vijim: (i) vendimin nr. ***, datë 11.11.2005, të KRRT-së Elbasan, për miratimin e sheshit të ndërtimit për z. L.K. në lagjen “***”, për objektin “bodrum + 8 kate + papafingo” në truallin me vërtetim pronësie nr. ***, me sipërfaqe 545 m²; (ii) vërtetimin hipotekor të pasurisë së shtetases L.K.; (iii) foto të ndërtimit; (iv) shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan³⁰; si dhe (v) certifikatë familjare të shtetasit E.K.
55. Nga shqyrtimi i fotove të vëna në dispozicion nga subjekti, duket se ndërtimi i godinës 8-katëshe, ende dhe sot pas kalimit të më shumë se 14 vjet, nuk ka përfunduar, madje dallohet me sy të lirë se ky ndërtim është vetëm 1 kat nga toka. Ndërtimi i pretenduar si zhvilluar/ndërtuar, i cili do të shkaktonte e dëmtim të hapësirave të apartamentit të subjektit, evidentohet me sy të lirë se nuk i është afruar dritareve dhe/apo ballkonit të apartamentit të subjektit në katin e katërt, në mënyrë të tillë që të krijonte pasoja/dëme reale konkrete për subjektin e rivlerësimit.
56. Përtej dokumentacionit të sjellë nga subjekti për të provuar burimin të ardhurave të z. E.K., ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Bashkëshortja e z. E.K. ka qenë e regjistruar si biznes privat nga viti 2003 dhe sipas DRT-së Elbasan, është regjistruar në organet tatimore me NIPT *** dhe për vitin 2005 ka deklaruar të ardhura në shumën 3.700.000 lekë dhe për vitin 2006 ka deklaruar të ardhura në shumën 4.500.000 lekë. Familja e z. E.K. ka pasur burimet e ligjshme për shumën 1.000.000 lekë që më ka dhënë për shkaktim dëmi”.*
57. Nga shqyrtimi i vërtetimit me nr. *** prot., datë 19.8.2021, nga DRT-ja Elbasan, për Personin Fizik “V.K.”, ky institucion ka referuar raportimin e të ardhurave nga shitja e mallrave /shërbimeve për vitin 2005, në shumën 3.700.000 lekë dhe për vitin 2006, në shumën 4.500.000 lekë, por rezulton se në këtë vërtetim nuk janë pasqyruar të dhëna mbi fitimet e realizuara nga ky person fizik, për të konkluduar mbi mundësinë e kursimeve të familjes K.
58. Nga sa më sipër, duket se përfitimi i shumës 1.000.000 lekë, ka qenë një veprim fiktiv, pasi mungon arsyeja apo shkaku real i dëmit të shkaktuar/pretenduar në të ardhmen, për aq kohë sa ndërtimi ende edhe sot nuk ka përfunduar, si dhe nuk është provuar me dokumentacion ligjor, burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë mundësuar dhënien e shumës 1.000.000 lekë nga shtetasi E.K.
59. Komisioni arrin në përfundimin se edhe në rast se do të provoheshin kushtet e mësipërme - në mungesë të provës mbi një dëm pasuror të pësuar konkretisht dhe realisht nga subjekti, si dhe nisur nga fakti që kjo shumë është përfituar nga subjekti në sajë të një dakordësimi vullnetar midis palëve - referuar nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit si përfitues i të ardhurave, ka pasur detyrimin për të paguar detyrimet përkatëse tatimore mbi shumën e përfituar, për sa kohë kjo e ardhur nuk ka qenë e parashikuar në nenin 8/1 të ligjit të sipërcituar, për të ardhurat e përjashtuara nga tatimi. Për rrjedhojë, në këto kushte, Komisioni nuk mund të konsideronte shumën në fjalë prej 1.000.000

³⁰Shkresë nr. ** prot., datë 19.8.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.

lekësh, si një të ardhur me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe nuk e ka përfshirë në analizën financiare.

60. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me sa më sipër, Komisioni i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme, lidhur me të cilat i është kaluar barra e provës:
- a) Duket se ka mospërputhje lidhur me vlerën 4.000.000 lekë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe vlerës së apartamentit në kontratën e sipërmarrjes prej 4.500.000 lekësh në vitin 2000 dhe vlerës 4.300.000 lekë që rezultojnë në kontratën e shitjes së vitit 2012.
 - b) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, ndonjë detyrim të mbetur pashlyer ndaj shoqërisë shitëse.
 - c) Duket se për kryerjen e pagesave të këstit të parë dhe të dytë në shumën totale 2.250.000 lekë të apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.662.740 lekë.
 - d) Lidhur me kundërshtëpërblimin e përfutur nga shtetasi E. K., nisur nga sa është përshkruar më lartë, duket se veprimi ka qenë fiktiv, pasi mungon arsyeja apo shkak real i dëmit të shkaktuar dhe apo të pretenduar në të ardhmen, për aq kohë sa ndërtimi në fjalë ende dhe sot nuk ka përfunduar, si dhe nuk është provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë mundur të dhënen e shumës 1.000.000 lekë.
 - e) Në përfundim të sa më sipër, ngrihen dyshime se mënyra e përfutimit të këtyre të ardhurave ngjan më shumë me një dhurim apo huadhënie të kamufluar dhe/ose si tentativë fiktiviteti për të justifikuar një të ardhur me burim të ndryshëm, për sa kohë - përpos paqartësisë se cilat kanë qenë parametrat e vlerësimit të dëmit të mundshëm - në këtë marrëdhënie mungon totalisht logjika ekonomike dhe shkak i mirëfilltë, në bazë të të cilës/it dikush duhet të paguaj një shumë, të cilësuar si dëmshpërblim, për një dëm që nuk e ka shkaktuar dhe, për rrjedhojë, shuma prej 1.000.000 lekësh, nuk mund të konsiderohet me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

61. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës dhe depozitimit të dokumentacionit në cilësinë e provës³¹, veç të tjerash, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, si më sipër, lidhur me konstatimin e parë mbi mospërputhjen e vlerës prej 4.000.000 lekësh të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, vlerës së apartamentit në kontratën e sipërmarrjes prej 4.500.000 lekësh në vitin 2000, si dhe vlerës prej 4.300.000 lekë në kontratën e shitjes në vitin 2012, subjekti ka prapësuar se deklarimi ka qenë i saktë, real dhe pa fshehur asgjë, duke treguar edhe burimin e të ardhurave.
62. Lidhur me mosdeklarimin prej tij të ndonjë detyrimi të mbetur pa shlyer shoqërisë ndërtuese në DIPP-në e vitit 2003, subjekti është shprehur se nuk ka deklaruar ndonjë detyrim të pashlyer ndaj palës shitëse, pasi nuk ka pasur detyrim të pashlyer dhe se pjesa e mbetur do t'i nënshtrohej kushteve të kontratës, ku parashikohej edhe zbritja e shumës prej 5%.

³¹Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.11.2021, të shtetasit A.G.; (ii) kërkesëpadi e shoqërisë "K****" sh.p.k.; (iii) vendimin nr. ***, datë 18.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (iv) kërkesëpadi e shtetasit A.Ç.

63. Ndërsa, lidhur me pagesën e kësteve të apartamentit, subjekti ka parashtruar se për shkak të kalimit të një kohë të gjatë prej 18 vjetësh është tejet mundësisë të mbajë mend momentet e pagimit të tyre, pasi për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe kalimit të afateve e ka të pamundur të përcaktojë momentin e pagimit të tyre. Subjekti ka pretenduar se nuk mund të hamendësohet lidhur me kohën e pagimit, duke iu referuar thjesht datave të kontratës me palën blerëse N* D*, pasi në përmbajtje kontrata është e qartë që pagesa është bërë jashtë zyrës noteriale, pa përcaktuar kohën e saktë të realizimit të pagesës, shoqëruar kjo edhe me deklarinë noterial të palës blerëse se pagesa është bërë e copëzuar në dy pagesa. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nga Komisioni është lënë jashtë përlllogaritjes shuma 1.950.000 lekë, padrejtësisht, duke pakësuar burimin e të ardhurave.
64. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka paraqitur një analizë financiare të kryer, duke konsideruar pagesën e shumës 4.000.000 lekë deri në fund të vitit 2003, në të cilat janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës 1995 – 2003, në përfundim të së cilës i ka rezultuar mundësia për pagimin e kësteve të apartamentit.
65. Subjekti është shprehur se konkluzioni se mungon arsyeja apo shkak real i dëmit të shkaktuar/prenduar në të ardhmen, del jashtë kompetencave të Komisionit. Ky është një konkluzion i hamendësuar, pasi dëmi ka ekzistuar, është provuar dhe për këtë fakt është investuar gjykata. Për shkak të arritjes së marrëveshjes, pasi pala e paditur u këshillua me avokatin mbrojtës, kjo kërkesëpadi u pushua me kërkesën e paditësit. Dëmi ishte real, i prekshëm dhe i pritshëm, referuar kondicioneve të ndërtimit që po ndiqte zbatuesi i punimeve. Subjekti është shprehur se nuk ka pasur lidhje me këtë shtetas, kështu që nuk kishte pse të kryente veprime fiktive. Zhvillimi i lejes së ndërtimit nuk ka vazhduar pasi shtetasi E.K. e shiti pronën e tij së bashku me lejen e ndërtimit. Po të shikohen pamjet e objektit, mbi katin e parë edhe sot e kësaj dite janë kolonat e betonit, si dhe formatet e hekurit për vazhdimin e ndërtimit. Në lidhje me burimin e të ardhurave për z. E. K., ky shtetas është djali i L.K., që më 19.6.2007 ka shitur pronën e saj së bashku me lejen e ndërtimit.
66. Shuma 1.000.000 lekë, nga dëmshpërblimi i vitit 2007, është e ardhur me burim të ligjshëm. Kjo shumë është dëmshpërblim për dëm të prekshëm, të mundshëm, real, ku vlera është përcaktuar me marrëveshje ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit. Për ekzistencën e këtij dëmi dhe vlerën e paguar është hartuar deklaratë noteriale nga shtetasi E.K., në vitin 2007, kohë kur koncepti *Vetting* nuk ekzistonte. Që ka ndërtuar pranë banesës, duke zënë ndriçimin për shkak të mosrespektimit të kondicioneve urbane, provohet përtej çdo dyshimi me lejen për ndërtim dhënë këtij shtetasi.
67. Lidhur me faktin se për këtë shumë nuk është paguar tatim, subjekti ka pretenduar se nuk kemi të bëjmë me një të ardhur në kuptimin e *legjislacionit tatimor mbi tatimin për të ardhurat*, është një kundërshtim, ku në çdo rast që gjykata njohin të drejtën e shpërblimit, mbi këtë dëmshpërblim nuk llogaritet tatimi dhe, për rrjedhojë, kjo e ardhur është mëse e ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

68. Komisioni, në analizë të të gjithë fakteve dhe provave, shpjegimeve dhe prapësimeve të lartpërmendura, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pas kalimit të barrës së provës, vlerëson se për sa i përket pagesës së kështit të parë dhe kështit të dytë,

subjekti i rivlerësimit, përveç deklaratës noteriale nuk arriti të provojë me dokumentacion të kohës, pagesën e kështit të parë dhe kështit të dytë për të provuar, sa ka pretenduar, se nuk janë paguar sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për pagimin e shumës totale – të pretenduar si të kryer deri në fund të vitit 2003 – mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe nuk mund të merren në konsideratë për të ndryshuar afatet e përlllogaritjeve të burimeve financiare përkatëse, për sa kohë ato nuk janë provuar me dokumentacion ligjor, si dhe as nuk ka rezultuar e deklaruar në deklaratën për vitin 2003 ndonjë shpenzim/investim i kryer përgjatë këtij viti për pasurinë në fjalë.

69. Gjithashtu, lidhur me pretendimin për arkëtimin paraprak të një pjese të çmimit të shitjes së një apartamenti ekzistues dhe, konkretisht, rreth 6 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, subjekti nuk arriti të provonte vërtetësinë e këtij pretendimi, pasi nuk vuri në dispozicion ndonjë dokumentacion për të provuar kryerjen e pagesës më herët nga sa është përshkruar në aktin përkatës. Ndërkohë që deklarata noteriale³² e vitit 2021 – nisur edhe nga jurisprudenca e konsoliduar tashmë mbi këto problematika – nuk mund ta ndryshojë përmbajtjen e aktit të shitjes, për sa kohë që nuk provohet e kundërta. Për më tepër që ky version nuk është deklaruar ndonjëherë më herët nga subjekti për sa i përket momentit të ndryshëm të kryerjes së pagesave hyrëse, nga shitja e pasurisë në fjalë.
70. Duke u nisur nga rrethanat e lartpërmendura, Komisioni arsyeton se referuar edhe jurisprudencës³³ se deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit, deklarata/at noteriale të paraqitura nga subjekti rivlerësimit si provë për të mbështetur pretendimet për pagesën e kështit të parë dhe kështit të dytë – nuk mund të vlerësohen bindëse dhe me vlerë provuese të mjaftueshme, për aq kohë sa nuk rezultojnë e provuar kryerja e pagesave të pretenduara me dokumentacion të kohës. Për më tepër që për shkak të paraqitjes së tyre përgjatë procesit të rivlerësimit, përmbajtja e tyre merret në konsideratë dhe vlerësohet me rezervë, pasi në mungesë të një kuadri provues mbështetës, krijohet bindja se ato janë konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ato nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.
71. Nga sa më sipër, mbështetur në një vlerësim të arsyeshëm të të gjitha rrethanave, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, lidhur me momentet e kryerjes së pagesave të kështit të parë dhe të dytë, në shumën 2.250.000 lekë, të apartamentit në analizë.
72. Për sa i përket analizës financiare të pagesave të kështit të parë dhe të dytë, brenda nëntorit të vitit 2000, duke mos e konsideruar të provuar arkëtimin e mëhershëm të pagesës së çmimit të shitjes së apartamentit ekzistues, edhe pas prapësimeve të subjektit, rezultati mbetet sërish negativ, ndonëse vlera negative ulet në masën -664,150 lekë, si pasojë e përfshirjes në analizë të dhurimeve të vëllait të subjektit, të provuara me dërgesat financiare nga SHBA-ja nëpërmjet Western Union dhe të Bankës së Kursimeve. Sa i përket kështit të tretë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për ta kryer atë pagesë me burime të ligjshme financiare.

³²Referohuni dy deklaratave noteriale të shtetasit A.G. dhe N.D.

³³Referohuni vendimeve të Kolegjit nr. (JR) 6/2018, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36 B.N.; dhe nr. (JR) 12, datë 27.2.2020, B.C.

73. Në vijim të administrimit, analizimit dhe vlerësimit të prapësimeve të subjektit, Komisioni në këtë analizë ka konkluduar, duke konsideruar pretendimet e subjektit, si vijon:
- i. Janë vlerësuar të provuara dhe janë përfshirë në analizën financiare përkatëse dhurimet e dërguara nga vëllai i subjektit nga SHBA-ja, në vitet 1998, 1999 dhe 2000 në masën 998.590 lekë. Kjo, pasi subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës printimin nga sistemi *online* të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të vëllait I.N., nga ku, për periudhën 1998 – 2010 që janë kryer dërgesat, ka përfituar të ardhura nga punësimi në masën 106.387 USD, si dhe pagesë për paaftësi në masën 30.313 USD, të cilat duken të mjaftueshme për shumën totale të dërguar prej 1.424.104 lekësh në një periudhë 12-vjeçare). Ndërkohë që, Komisioni ka marrë në konsideratë, sipas dokumentacionit të paraqitur, edhe dërgesën e datës 17.2.2000, prej 6.119,25 USD në vend të 119,25 USD – ndryshe nga sa është pretenduar nga subjekti (ndoshta lapsus), për një shumë ndjeshëm më të vogël, në masën totale të dërguar prej 581.651 lekë.
 - ii. Nuk janë konsideruar bindëse apo të provuara modifikimet e kërkuara nga subjekti, lidhur me shpenzimet e jetesës, të pretenduara prej tij për periudhën 1995 – 2002, për sa kohë nuk provohet e kundërta e të dhënave statistikore të marra në konsideratë në praktikën e vazhdueshme të Komisionit. Gjithashtu, pretendimet e subjektit nuk përputhen me parametrat dhe standardet e mbajtura në praktikën e Kolegjit dhe/ose të Komisionit. Për më tepër që, këto shpenzime të përlllogaritura sipas subjekti në vlerën 1.024.000 lekë, rezultojnë edhe më të larta se ato të konsideruara e përlllogaritura nga Komisioni, në vlerën prej 935.000 lekë. Kësisoj, vërehet se në këtë rast, nëse nga Komisioni do të përlllogaritej vlera e shpenzimeve që është paraqitur nga subjekti, në mënyrë paradoksale si efekt final do të shtonte balancën negative.
74. Lidhur me pretendimin mbi përfitimin e shumës 1.000.000 lekë nga shtetasi E.K., si dëmshpërblim për pengesën e dritës nga ndërtimi i ardhshëm, bazuar në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet e subjektit në prapësime por edhe gjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues krijon bindjen se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit³⁴, për përfitimin e këtyre të ardhurave kanë qenë fiktive, pasi: (i) ngelet e paqartë dhe e paprovuar mënyra dhe momenti i përfitimit të tyre; (ii) mungon logjika ekonomike, pasi nuk ka rezultuar ndonjë dëm konkret shkaktuar ndaj subjektit, i cili mund të justifikonte dëmshpërblimin e paguar në favor të tij; (iii) përfitimi ngjason më shumë me një dhurim të kamufluar si dëmshpërblim; (iv) bashkë paditësi në gjykatën civile, lidhur me parregullsitë e lejes së ndërtimit, nuk ka përfituar ndonjë dëmshpërblim sikurse ka përfituar subjekti – nuk është i qartë shkaku i tërheqjes së padisë civile apo mosinteresimit për çështjen në fjalë të personit tjetër (A.Ç.), bashkë paditës;(v) mbetet, gjithashtu, e paqartë përse vetëm subjekti ka përfituar një dëmshpërblim (veç të tjerash pa parametra përlllogaritës së dëmit të mundshëm në formën e duhur ligjore) dhe askush nga pronarët e dhjetëra apartamenteve të të njëjtit pallat, me dritare nga ana ndërtimit të nisur (por të mbetur në katin e parë), nuk ka përfituar asnjë dëmshpërblim; (vi) shtetasi E.K., personi që pretendohet se ka paguar *cash* dëmshpërblimin prej 1.000.000 lekësh në favor të subjektit, nuk ka pasur asnjë legjitimim, për sa kohë truall mbi të cilin ka nisur ndërtimi fillimisht ishte në

³⁴Kërkesë padia është ngritur ndaj shtetases L.K. nga subjekti Binas Nina dhe shtetasi A.Ç.; deklarata noteriale ndërmjet E.K. dhe subjektit të rivlerësimit e më pas vendimi nr. ***, datë 13.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

emër të nënës së tij dhe kjo pasuri është tjetërsuar përpara se të kryhej vetë dëmshpërblimi. Pra, veç legjitimitit pagesit të dëmshpërblimit i mungonte edhe shkaku dhe interesi për dhënë këtë dëmshpërblim, për sa kohë as nëna e tij nuk e kishte më në përdorim truallin mbi të cilin kishte nisur ndërtimi. Rrethanat e mësipërme krijojnë bindjen se është kryer një tentativë dëmshpërblimi fiktiv për të justifikuar këto të ardhura me burim të ndryshëm nga ai i deklaruar, për sa kohë, subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor: ekzistencën dhe mënyrën e vlerësimit të dëmit të mundshëm; kohën; mënyrën dhe masën e pagesave të kryera në favor të subjektit; legjitimitimin dhe interesin e deklaruesit si pages i dëmshpërblimit të vetëm, pa pasur asnjë të drejtë reale mbi truallin/shesh ndërtimi apo mbi lejen e ndërtimit, objekt padie. Këto konkluzione bazohen edhe në faktet e mëposhtme.

75. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni për këtë çështje, ka rezultuar se me vendimin nr. ***, datë 11.11.2005, KRRT-ja Elbasan i ka miratuar shtetases L.K. (e cila sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, ka qenë pronare e vetme e pasurisë nr. ***), lejen e ndërtimit për ndërtimin e godinës së banimit me afat deri më 22.12.2006.
76. Kërkesë padia është ngritur ndaj shtetases L.K. dhe depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan nga subjekti Binas Nina dhe shtetasi A.Ç.dhe është regjistruar sipas shënimit “nr. *** regj., ***, datë 6.7.2006³⁵”, ndërkohë nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 13.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan³⁶, konstatohet se nr. i regjistrimit themeltar është “nr. ***”, çka duket se nuk përputhet me numrin e regjistrimit të padisë në vitin 2006, duke krijuar kështu bindjen se nuk bëhet fjalë për të njëjtën kërkesë padi të ngritur ose së paku jo atë të datës 6.7.2006 dhe të regjistruar me nr. regjistri ***.
77. Më tej, ka rezultuar se znj. L.K. (me cilësinë e palës shitëse) ka nënshkruar një kontratë shitje trualli në datën 19.6.2007, me palën blerëse A.B., për shitjen e truallit në fjalë (mbi të cilin do të ndërtohej godina), kundrejt çmimit 10.000.000 lekë, shumë kjo e marrë e gjitha në dorë, referuar përmbajtjes së kontratës së shitblerjes (e cila daton rreth 3 muaj përpara dhënies së shumës 1.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit, nga z. E.K., më 27.9.2007).
78. Me vendimin nr. ***, datë 13.9.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka vendosur “pushimin e gjykimit të padisë së paditësit Binas Nina”, për shkak të heqjes dorë nga ana e subjektit dhe mosparaqitjes së paditësit tjetër A.Ç. në seancat e zhvilluara.
79. Me vendimin nr. ***, datë 24.9.2007, të KRRT-së së Bashkisë Elbasan i është miratuar leja e re e sheshit të ndërtimit për godinën, pronarit të ri të truallit, z. A.B., mbi të cilin do të ndërtohej godina e banimit.
80. Me deklaratën noteriale të datës 27.9.2007, shtetasi E.K. (i biri i zj. L.K.) ka deklaruar që se bashku me nënën L.K. janë pronar të truallit, dhe se i ka dhënë shumën prej 1.000.000 lekësh si kundërshtëpërblim subjektit të rivlerësimit Binas Nina, i cili ka deklaruar se: “*Heq dorë nga e drejta e padisë për pengimin e shfuqizimit të lejes së ndërtimit*”.
81. Trupi gjykues, nga studimi i materialit të vënë në dispozicion nga subjekti përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe një analizë kronologjike e veprimeve juridike të pasqyruara më lart,

³⁵Në objektin e kësaj padie është kërkuar gjithashtu marrja e masës së sigurimit, e cila referuar Kodit të Procedurës Civile duhet të gjykohet brenda afatit 5-ditor.

³⁶Vendimi i Gjykatës së Rrethit Elbasan, i cili ka pushuar çështjen civile me nr. *** akti, datë 13.9.2007.

vlerëson jo bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe çmon se këto veprime kanë qenë fiktive me qëllim përfitimin e të ardhurave fiktive, nisur kjo nga mospërputhjet e konstatuara dhe mungesës së sensit logjik në veprimet juridike të kryera nga personat të cilëve iu atribuoheshin të drejtat pasi:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar dhe përfituar të ardhura nga shtetasi E.K. (i biri i zj. L.K.), ndërkohë që as ai dhe as nëna e tij, nuk gëzonin më tagrat e pronarit të ligjshëm të pasurisë truall mbi të cilin do të ndërtohej godina. Pronësia mbi truallin ka qenë në emër të shtetases L.K. deri në datën 19.6.2007 dhe, më tej, ka kaluar në emër të pronarit të ri, z. A.B., për të cilin më pas ka dalë edhe leja e ndërtimit në datën 24.9.2007, pra, në momentin e dhënies së vendimit të pushimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan pronar i ligjshëm ka qenë shtetasi A.B.
- ii. Ndërkohë, lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se edhe banorë të tjerë kanë përfituar dëmshpërblim, për të cilat nuk mundet të japë një shifër konkrete (shpjegime të dhëna në seancën dëgjimore), trupi gjykues vlerëson se ato nuk kanë qenë bindëse, pasi mungon logjika e dhënies së një dëmshpërblimi nga shtetasi E.K. apo L.K., për një truall të cilin e kishin shitur më herët dhe për një ndërtim që tashmë do të kryhej nga një tjetër individ, z. A.B. (pronari i ri i truallit dhe lejes së ndërtimit).

82. Përtej sa më sipër, Komisioni – ndryshe nga sa pretendohet nga subjekti mbi mospasjen e detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurat e përfituara – vlerëson se: (i) fillimisht nuk jemi përpara një dëmshpërblimi të vendosur nga gjykata, pasi dëmshpërblimi i përfituar nga subjekti ka ardhur si pasojë e marrëveshjes midis palëve; si dhe (ii) edhe sikur nga subjekti të ishte konsideruar si i tillë, nga shqyrtimi i ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ka rezultuar se kjo nën pikë “9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore”, e nenit 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, është shtuar me anë të ligjit nr. 122/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, 5 vjet pas përfitimit të të ardhurave nga dëmshpërblimi në fjalë.
83. Nga sa më sipër, konkluzionet e rezultateve të hetimit që i janë njoftuar subjektit për këtë pikë nuk mund të ndryshojnë, pasi Komisioni vlerëson se në këtë marrëdhënie mungon logjika ekonomike dhe shkak i ligjshëm në bazë të të cilit dikush duhet të paguajë një kundërshtëpërblim për një dëm që nuk e ka shkaktuar dhe për më tepër që “dëmshpërblyesi” nuk e ka pasur cilësimin/tagrin e duhur ligjor që të përfaqësonte investitorin e ndërtimit, (dëmtuesin) dhe, ndërkohë, as familjari i tij nuk kishte më të drejta reale mbi truallin në momentin e dakordësimit të dëmshpërblimit të pretenduar. Në çdo rast, edhe sikur të merrej i mirëqenë dëmshpërblimi i pretenduar dhe i deklaruar nga subjekti, shuma e përfituar gjithsesi nuk do të rezultonte e ligjshme, në këndvështrimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk është provuar as dëmi i pësuar dhe as tatimi mbi shumën e përfituar, për sa kohë ajo në këto kushte nuk rezulton midis fitimeve monetare të përjashtuara nga pagesa e tatimit. Rrjedhimisht shuma *de qua*, prej 1.000.000 lekësh, nuk mund të konsiderohet në analizën financiare si një burim i ligjshëm dhe i disponueshëm nga subjekti.

2. Tokë “arë”, me sip. 33.734 m², në fshatin K*, Bashkia Bulqizë**

84. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, me pjesë takuese 1/6. Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit ka rezultuar se pasuria është përfituar me anë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, të rrethit Bulqizë, Fshati K***, datë 10.8.1994, për dhënien në pronësi të sipërfaqes totale prej 33.734 m², kryefamiljarit D.N.³⁷, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar³⁸.
85. ASHK-ja Bulqizë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2020, ka bërë me dije se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nisur nga fakti se subjekti ka deklaruar pjesën takuese mbi këtë pasuri, Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi të bënte me dije mbi arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 dhe në vijim, deri në deklaratën *Vetting*, gjithashtu të informonte dhe të vinte në dispozicion foto aktuale të pasurisë në fjalë, duke bërë me dije nëse mbi të është kryer ndonjë investim i mundshëm.
86. Nga sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se në deklaratimet periodike (që në herën e parë dhe në deklaratimet e çdo viti) ka deklaruar pasuritë e regjistruara në emrin tij dhe të familjes, por nuk ka deklaruar pasuritë ku ka qenë pjesëtar, pasi formulari nuk ka pasur rubrikë ku të gjente pasqyrim një situatë e tillë. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në tokën në fshatin K***, nuk ka kryer ndonjë investim/ndërtim. Së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti ka paraqitur disa foto të tokës në fjalë, nga të cilat nuk duket të ketë ndonjë investim/ndërtim.
87. Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese mbi këtë pasuri të paluajtshme dhe të drejta të reale mbi të, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 dhe në vijim, në kundërshtim me ligjin nr. 9046, datë 10.4.2003 dhe deri në deklaratën *Vetting*, ndonëse nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të saj.
88. Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave në lidhje me mosdeklarimin e pasurive të subjektit në bashkëpronësi me anëtarët e familjes bujqësore, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet ligjit nr. 9046, datë 10.4.2003.

3. Tokë “arë”, me sip. 4.000 m², në pronësi të bashkëshortes së subjektit, në L*-F*****

89. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, me pjesë takuese 1/4. Nga dokumentacioni i paraqitur ka rezultuar se pasuria është përfituar me anë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi³⁹, të rrethit Elbasan, fshati L***-F***, datë 13.8.1993, për dhënien në pronësi të sipërfaqes totale prej 4.000 m²,

³⁷Referuar certifikatës familjare të trungut familjar, lëshuar më 24.1.2017, nr. ***, konfirmon se subjekti ka qenë anëtar i familjes bujqësore, në datën 1.8.1991.

³⁸Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, janë subjekt i përfitimit të tokës bujqësore, familjet anëtare të kooperativës bujqësore, të cilat rezultojnë të tilla sipas certifikatës së gjendjes civile të datës 1.8.1991. Nisur nga deklarimi i subjektit dhe vënies në dispozicion të certifikatës së gjendjes civile, konstatohet se ai ka qenë anëtar i familjes bujqësore, pra, për rrjedhojë, bashkëpronar në pasurinë në fjalë, sipas AMTP-së së sipërcituar.

³⁹Pa numër.

kryefamiljarit I.B.⁴⁰, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar⁴¹.

90. ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2020, nuk ka konfirmuar pronësinë e bashkëshortes për pasuri të paluajtshme të llojit tokë arë.
91. Nisur nga fakti se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pronësinë mbi këtë pasuri, Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi të bënte me dije mbi arsyen e mosdeklarimit, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 deri në deklaratën *Vetting*, si dhe nëse mbi këtë pasuri është kryer ndonjë investim i mundshëm.
92. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se në deklaratimet periodike që nga deklarimi për herë të parë dhe në deklaratimet e çdo viti ka deklaruar pasuritë të regjistruar në emrin e tij, por nuk ka deklaruar pasuritë ku ai apo pjesëtarët e familjes së tij kanë pasur pjesë ideale, pasi formulari nuk ka pasur rubrikë ku të gjente pasqyrim një situatë e tillë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se pjesëtimi i pasurisë nuk është bërë dhe toka nuk është regjistruar. Kryetari i familjes bujqësore I.B., para disa viteve e ka mbjellë me fidanë ullinj dhe se në këtë sipërfaqe nuk ka kryer asnjë investim. Së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti ka paraqitur disa foto nga të cilat nuk duket të ketë ndonjë investim/ndërtim.
93. Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese të bashkëshortes dhe të drejta të reale mbi të, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 dhe në vijim, në kundërshtim me ligjin nr. 9046, datë 10.4.2003 dhe deri në deklaratën *Vetting* ndonëse nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të saj.
94. Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave në lidhje me mosdeklarimin e pasurive në bashkëpronësi të bashkëshortes së tij me anëtarët e familjes bujqësore, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet ligjit nr. 9046, datë 10.4.2003.

4. Automjet tip, “Mercedes-Benz”, me targa ***

95. Ky automjet është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2013, si pasuri e krijuar me kontratën e shitblerjes së datës 8.12.2013, në vlerën 600.000 lekë, por nuk është përshkruar burimi i krijimit të saj. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie me të ardhura: (i) në shumën 300.000 lekë nga shitja e automjetit me targa ***; dhe (ii) në shumën 300.000 lekë nga të ardhurat e vitit 2013.
96. Pasuria është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.12.2013, midis palës shitëse A.B.⁴² dhe palës blerëse Binas Nina, për shitjen e automjetit tip “Mercedes- Benz B180”, nr. Shasi ***, kundrejt çmimit 600.000 lekë.

⁴⁰Sipas certifikatës së datës 1.8.1991, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, datë 24.1.2017, me nr. serial ***, bashkëshortja F.N. ka qenë anëtare e familjes bujqësore.

⁴¹Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, janë subjekt i përfitimit të tokës bujqësore, familjet anëtare të kooperativës bujqësore, të cilat rezultojnë të tilla sipas certifikatës së gjendjes civile të datës 1.8.1991. Nisur nga deklarimi i subjektit dhe vënies në dispozicion të certifikatës së gjendjes civile, konstatohet se bashkëshortja e subjekti ka qenë anëtare i familjes bujqësore, pra, për rrjedhojë, bashkëpronare në pasurinë në fjalë, sipas AMTP-së së sipërcituar.

⁴²Referuar shkresës nr. *** prot., datë 18.5.2021, Prokuroria e Rrethit Elbasan ka informuar se nga verifikimi ka rezultuar se për shtetasit A.B., D.K., I.K., dhe A.B., nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penale për shtetasit e përmendur në këtë shkresë.

97. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se automjeti ishte blerë më parë në datën 1.11.2013, në Gjermani, me faturën nr. ***, kundrejt çmimit 3.500 euro⁴³.
98. Nga tërësia e veprimeve dhe dokumentacionit të disponuar, duket se nuk ka logjikë ekonomike, veprimi i mësipërm i blerjes së një automjeti me kosto prej së paku 700.000 lekë, i cili i është shitur më pas subjektit, brenda një afati shumë të shkurtër kohor, me një çmim më të ulët se investimi i kryer nga pala shitëse.

4.1 Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

99. Referuar dokumentacionit të ardhur nga DPSHTRr-ja, datë 11.2.2020⁴⁴, rezulton se automjeti me targa ***, është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, duke bashkëlidhur edhe kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.12.2013, për blerjen e automjetit.
100. Më tej, ka rezultuar se automjeti në fjalë u është shitur shtetasve D. dhe I.K., kundrejt çmimit 300.000 lekë, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 20.12.2013.
101. Kontratë shitblerje nr. ***, datë 9.3.2003, e nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse A.B., për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me vit prodhimi 1992, kundrejt çmimit 300.000 lekë.

4.2 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

102. Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm në datën 20.12.2013, të deklaruara si burim për blerjen e automjetit të ri në datën 8.12.2013, duket se ato nuk mund të ishin përdorur për sa kohë datojnë rreth 2 javë pas blerjes së pasurisë.
103. Pyetur nga Komisioni, lidhur me mospërputhjen e rezultuar midis momentit të blerjes së automjetit të ri dhe shitjes së automjetit ekzistues rreth 2 javë më pas, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se: *“Blerësit D.K. dhe I.K., janë nipërit e gruas sime F.N. Pasi kemi rënë dakord për çmimin dhe ata kanë bërë pagesën, duke qenë se ishin lidhje familjare e bashkëshortes, mjetin ua kam lënë në provë për një periudhë 2 javore. Pasi janë bindur për gjendjen teknike të mjetit kemi hartuar kontratën e shitjes”*.
104. Për të provuar sa më sipërpretenduar, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale, datë 13.8.2021, të lëshuar nga z. I.K., i cili ka deklaruar se ka nënshkruar kontratën e shitjes së bashku me motrën e tij në datën 20.12.2013, por automjeti është mbajtur për provë nga 7.12.2013 – 20.12.2013 dhe shuma 300.000 lekë është paguar në datën 7.12.2013, pasi shitësi do të blinte një automjet tjetër.
105. Lidhur me këto të ardhura, të pretenduara si të marra/disponuara që në datën 7.12.2013, ndërkohë që kontrata e shitblerjes është nënshkruar në datën 20.12.2013, në mungesë të një prove të kohës për kryerjen e parapagimit, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, pasi deklaratat e mëpasshme nuk mund të zhbëjnë çka është shprehur përpara noterit në një kontratë shitblerjeje, e cila është regjistruar dhe i ka prodhuar efektet e saj reale në datën 20.12.2013. Përmbajtja e kësaj të fundit prevalon mbi çdo deklaram apo

⁴³Shtetasi A.B., ka kryer zhdoganimin e automjetit në datën 15.11.2013, me vlerën 210.575 lekë, nga ku duket se investimi total i këtij shtetasi për këtë automjet ka qenë në vlerën totale 701.310 lekë

⁴⁴Shkresat nr. *** prot., datë 17.10.2016; nr. *** prot., datë 21.7.2017, si dhe nr. *** prot.

pretendim ndryshe, për sa kohë në të nuk është cituar asgjë lidhur me pagesën e çmimit më herët.

106. Po ashtu, nga shqyrtimi i deklaratave periodike të subjektit, ka rezultuar se në vitin 2013 nuk ka deklaruar ndonjë pakësim të gjendjes së disponuar *cash* në banesë. Për rrjedhojë, Komisioni ka përlllogaritur si burim për kryerjen e pagesës së çmimit total prej 600.000 Lekë, vetëm të ardhurat nga punësimet përkatëse të subjektit dhe të bashkëshortes përgjatë periudhës 1.1.2013 – 7.12.2013.
107. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe të anëtarëve të familjes, ka rezultuar se përgjatë periudhës së analizuar kanë kryer tërheqjet nga llogaritë e tyre të pagesës të shumave: (i) shuma 80.000 lekë tërhequr nga bashkëshortja e subjektit në datën 11.1.2013; (ii) shuma 30.000 lekë tërhequr nga subjekti në datën 17.1.2013; (iv) shuma 30.000 lekë tërhequr nga subjekti në datën 14.2.2013; dhe (v) shuma 900.000 lekë tërhequr nga subjekti në datën 8.11.2013.
108. Nga sa më sipër, rezulton se për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në datën 7.12.2013, subjekti ka pasur mundësi për kryerjen e pagesës së shumës 600.000 lekë, me fondet e tërhequra në datën 8.11.2013.
109. Ndërkohë, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kanë tërhequr fonde të tjera, as nga llogaritë e tjera të disponuara, nga ku duket se përveç shumës 140.000 lekë të tërhequr në muajt janar dhe shkurt të vitit 2013, nuk ka pasur burim tjetër të ardhurash në këtë vit, të mundshme për t’u përdorur për jetesën e familjes deri në muajin nëntor⁴⁵.
110. Nga verifikimet e kryera, vërehet se dhe në vitin 2014 është përsëritur e njëjta situatë, nga ku as subjekti dhe as bashkëshortja nuk kanë kryer asnjë tërheqje nga llogaritë përkatëse të pagave, përveçse në datën 17.12.2014, shumën 1.335.400 lekë prej subjektit, ndërsa bashkëshortja të gjithë shumën e akumuluar gjatë vitit e ka investuar në depozitë me afat.
111. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e automjetit në fjalë me burime të ligjshme financiare. Kësisoj, nuk janë gjetur problematika lidhur me burimin e krijimit apo me deklarimin e kësaj pasurie.
112. Në vijim të arsytimit të mësipërm, ka rezultuar se nuk ka logjikë ekonomike në veprimin e blerjes së automjetit në analizë nga pala shitëse me një kosto prej së paku në shumën 700.000 lekë, shitur më pas subjektit, brenda një afati shumë të shkurtër kohor, me një çmim më të ulët se investimi i kryer. Gjithashtu, mbetet e paqartë edhe shitja e automjetit ekzistues tip “Mercedes-Benz”, pas 10 vjetësh përdorimi dhe amortizimi me të njëjtin çmim të blerjes në vitin 2003, duke i kërkuar subjektit edhe shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

113. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e sjella ka mbajtur qëndrimin se blerja e automjetit dokumentohet me kontratën në të cilën është shprehur vullneti i palës shitëse, i cili për shitjen

⁴⁵Ndërkohë që, vetëm shpenzimet e jetesës për një familje prej 4 personash, në vitin 2013, kanë qenë së paku në shumën 564.096 lekë, pa përfshirë në llogaritje shpenzimet e tjera të kryera nga familja e subjektit përgjatë atij viti për arsimimin e fëmijëve si dhe shpenzimet e udhëtimeve familjare.

kërkoi çmimin e pasqyruar në kontratë. Subjekti ka pretenduar se nuk janë të pakta rastet kur për një mori arsyesh ekonomike, shëndetësore, emigracioni, makinat janë shitur me çmim më të ulët.

114. Konkluzioni që nuk ka logjikë ekonomike është i hamendësuar dhe jo i bazuar në të dhënat e grumbulluara për interes të këtij hetimi administrativ. Në lidhje me kontratën e shitblerjes së datës 20.12.2013, nënshkruar mes subjektit dhe blerësve D. e I.K., ka sqaruar se automjeti është shitur në vlerën që është blerë, pasi ka qenë në gjendje të mirë. Pasi kanë rënë dakord për çmimin dhe kanë bërë pagesën, duke qenë se ishin lidhje familjare të bashkëshortes, automjeti u është lënë në provë për një periudhë 2-javore.
115. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se pavarësisht se Komisioni ka konstatuar që ka pasur të ardhura për të blerë automjetin, padrejtësisht nuk përfshihet në analizë shuma 300.000 lekë e shitjes.

Vlerësimi i trupit gjykues

116. Komisioni, në analizë tërësore të rrethanave, arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, ndonëse nuk është konstatuar ndonjë lidhje me palën shitëse apo blerëse për të konkluduar në një trajtim preferencial të padeklaruar prej subjektit, apo konflikt interesi, por situatat e mësipërme pa logjikë ekonomike do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit, për sa kohë nuk mund të përbëjnë në vetvete shkak për shkarkim.

5. Depozitë kursimi e subjektit, në masën 11.078 euro, në “Credins Bank”

117. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo depozitë bankare është depozituar fillimisht *cash* në llogarinë e subjektit në “Credins Bank”, prej këtij të fundit, në datën 6.12.2010, në shumën 17.000 euro, me përshkrimin “derdhje nga Binas Nina për çelje depozitë 3-mujore”. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2010, konstatohet se subjekti ka deklaruar te shtesat “depozitë në ‘Credins Bank’, në datën 6.12.2010”, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj. Më pas, në datën 7.9.2011, ka tërhequr nga kjo depozitë shumën 7.000 euro dhe, ndër vite, është shtuar me të ardhurat nga interesat, duke rezultuar në momentin e deklaratës *Vetting*, shuma prej 11.078 euro.
118. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në fjalë me burim nga: (i) tërheqje bono thesari në shumën 800.000 lekë në vitin 2010; (ii) mbyllja e depozitës bankare në “Credins Bank”, në shumën 1.685.812 lekë; si dhe (iii) interesa bankare në shumën 1.078 euro, duke deklaruar, gjithashtu, edhe burimet përkatëse të bonove të thesarit në shumën 800.000 lekë, si dhe të depozitës bankare në shumën 1.685.812 lekë.

5.1 Burimet e krijimit të bonove të thesarit, në shumën 800.000 lekë

119. Nga verifikimet e kryera në llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, ka rezultuar se subjekti ka investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë shumën 800.000 lekë, fillimisht në datën 24.3.2006 dhe më pas është riinvestuar deri në datë 18.6.2010, datë në të cilën shuma 796.943 lekë është transferuar në “Credins Bank”, më pas, në datën 1.9.2010, subjekti e ka tërhequr *cash*, shumën 800.000 lekë. Si burimin krijimi të kësaj shume, subjekti ka deklaruar: (i) pakësim i pagës së pa tërhequr të subjektit në “Raiffeisen Bank”; (ii) pakësim i pagës së pa

tërhequr të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”; si dhe (iii) fondet e tërhequra nga depozita në shumën 565.467 lekë në “Raiffeisen Bank”, krijuar para vitit 2003.

120. Nga verifikimet e llogarive bankare ka rezultuar se përgjatë periudhës janar – 24.3.2006, subjekti ka tërhequr nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”, shumën 510.000 lekë, ndërsa bashkëshortja nuk ka kryer tërheqje nga llogaria e pagës.
121. Po ashtu, ka rezultuar se në datën 24.3.2006, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 679.724 lekë, nga depozita saj e kursimit në “Raiffeisen Bank”. Kjo depozitë është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, si e krijuar prej bashkëshortes në vitin 2000, për të cilën në vijim të analizës së kryer, për investimet dhe shpenzimet e kryera gjatë atij viti, duket se ata nuk kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të kryer investimet në dy pasuri të paluajtshme dhe në investimin në depozitë kursimi. Për rrjedhojë, duket se ka një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 500.000 lekë, në vitin 2000 për të gjithë investimin në depozitë bankare, e cila është përdorur më pas për investimin në bonot e thesarit në vitin 2006, të përdorura si burim për investimin e subjektit në vitin 2010 të shumës 17.000 euro.
122. Nga sa më sipër, ka rezultuar se për të kryer investimin në shumën 500.000 lekë në depozitë në Bankën e Kursimeve, të cilat më pas kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në analizë në “Credins Bank”, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 500.000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

123. Në prapësimet e depozituara, subjekti është shprehur se për shumën 500.000 lekë të depozituar në Bankën e Kursimeve nga bashkëshortja në vitin 2000, ka pasur burime të mjaftueshme financiare, nga të ardhurat nga pagat për periudhën 1995 – 2000, të cilat kanë qenë në shumën 2.206.084 lekë. Referuar këtyre, familja ka pasur të ardhura të mjaftueshme që bashkëshortja të depozitonte këtë shumë dhe se për blerjen e pasurisë apartament ka treguar burimin e të ardhurave, nga ku vetëm shuma 150.000 lekë është me burim nga pagat, ndërsa pjesa tjetër rrjedh nga shitja e apartamentit të mëparshëm.
124. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se mos përfshirja në analizën financiare nga e Komisioni e shumës 1.500.000 lekë, të përfituar nga shitja e mëparshme, padrejtësisht pakësojnë kursimet nga pagat, duke rezultuar në pamundësi financiare.

Vlerësimi i trupit gjykues

125. Për sa më sipër, në konkluzion të analizës së pasurisë apartament banimi të detajuar më sipër, të dokumentacionit të administruar, të përgjigjeve dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit provues të paraqitur prej tij, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë nuk është provuar me ndonjë dokument të kohës arkëtimi i mëhershëm i një pjesë të çmimit të shitjes së apartamentit në lagjen “***”, që mund të mundësonte/justifikonte përdorimin e tyre në blerjen e apartamentit të ri në lagjen “***”, Elbasan dhe, për pasojë, të mundësonte më pas edhe kursimin dhe përdorimin e të ardhurave nga pagat për këtë investim.
126. Nga sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se për të kryer investimin në shumën 500.000 lekë, në depozitë në Bankën e Kursimeve, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë totale të burimeve të ligjshme financiare, pra, shumën 500.000 lekë.

5.2 Burimet e krijimit të depozitës, në shumën 1.685.812 lekë, në “Credins Bank”

127. Kjo depozitë është investuar për herë të parë në datën 9.1.2006, duke u depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit shuma prej 1.300.000 lekë në llogarinë e tij në “Credins Bank”. Më pas, kjo shumë ka vijuar të qëndrojë e investuar, duke u shtuar me të ardhurat nga interesat, deri në datën 8.11.2010, duke arritur vlerën 1.685.812 lekë. Lidhur me burimin e krijimit të shumës 1.300.000 lekë, të depozituar në vitin 2006, subjekti ka deklaruar fondet e tërhequra nga depozita në shumën 679.724 lekë, në “Raiffeisen Bank”, krijuar në vitin 2000.
128. Nga verifikimet e kryera në lëvizjet e llogarive bankare, ka rezultuar se depozita në “Raiffeisen Bank” është tërhequr në mars të vitit 2006 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ishte përdorur si burim për depozitimin e shumës 1.300.000, në janar të vitit 2006. Ndërsa depozita e kursimit në shumën 565.467 lekë është tërhequr prej subjektit në datën 30.12.2005. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesën e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, në masën 300.000 lekë, të cilat së bashku me kursimet e deklaruara vitin e mëparshëm në shumën 800.000 lekë, përbëjnë shumën totale 1.100.000 lekë, në të cilat konsiderohen të përfshira edhe fondet e tërhequra nga depozita në “Raiffeisen Bank”, për sa kohë ato janë tërhequr në datën 30.12.2005.
129. Nga llogaritë e pagave respektive, subjekti dhe bashkëshortja kanë tërhequr gjatë periudhës 1.1.2006 – 9.1.2006, vetëm shumën prej 20,000 lekë. Për pasojë, duke konsideruar përdorimin e të gjithë kursimeve të deklaruara si të disponuara *cash* në banesë, duket se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në datën 9.1.2006, për të depozituar shumën 1.300.000 lekë, në masën 190.956 lekë.

Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve për investimin në depozitë

Të ardhura nga pagat 1.1.2006 - 9.1.2006	20 000
Kursime <i>cash</i> në banesë	1 100 000
Shpenzime të familjes 1.1.2006 - 9.1.2006	- 10 956
Investuar në depozitë	- 1 300 000
Rezultati	- 190 956

130. Ndërkohë, në DIPP-në vitin 2006, subjekti ka deklaruar shtimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë në shumën 300.000 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni ka përlogaritur mundësinë e subjektit për të rikrijuar kursimet e disponuara në fillim të vitit 2006, së bashku me shtesën e deklaruar gjatë vitit, në shumën totale 1.400.000 lekë.
131. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e tij e pagës shumën 1.165.000 Lekë, ndërsa bashkëshortja shumën 297.500 Lekë. Gjatë këtij viti është tërhequr depozita bankare e bashkëshortes në shumën 679.724 lekë dhe është investuar në bono thesari shuma 800.000 lekë. Në përfundim të analizës si më sipër, duket se për të rikrijuar kursimet e pretenduara *cash* në fund të vitit, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4 – Analiza e burimeve për rikrijimin e kursimeve cash

Të ardhura nga pagat 9.1.2006 - 31.12.2006	1 462 500
Tërhequr fondet e depozitës në RZB	679 724
Investuar në bono thesari	- 800 000
Të ardhura nga interesat e BTH	71 528
Shpenzime të familjes 9.1.2006 - 31.12.2006	- 566 244
Kursime cash në banesë në fund të vitit 2006	- 1 400 000
Rezultati	- 552 492

132. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për rezultatet e mëposhtme:

- a) për të kryer investimin në shumën 1.300.000 lekë, datë 9.1.2006, në depozitë në “Credins Bank”, të cilat më pas kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 190.956 lekë;
- b) ndërkohë, lidhur me rikrijimin e kursimeve cash, të pretenduara si të disponuara në fund të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 552.492 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

133. Subjekti është shprehur se tërheqja nga depozita e kursimit në shumën 565.467 lekë nuk është deklaruar në DIPP-në të vitit 2005, por të vitit 2006, duke treguar në formularin e deklarimit dhe datën e pakësimit më 30.12.2005, me pretendimin se ka dashur të jetë në rregull sipas dokumentacionit bankar, pasi veprimet që kryhen në ditët e fundit të vitit banka i pasqyrojnë me datat e fillimit të vitit pasardhës. Në këtë mënyrë shuma 565.467 lekë nuk është e përfshirë në gjendjen *cash* të vitit 2005. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se po të përfshihet shuma 565.467 lekë në analizë do të rezultojë që ka pasur mundësi për të kryer investimin në shumën 1.300.000 lekë, si dhe për të krijuar kursimet *cash* në fund të vitit 2006.

134. Në lidhje me tërheqjen në mars të vitit 2006 dhe deklarimin si burim për krijimin e investimit në janar të këtij viti, subjekti ka shpjeguar se deklarimi periodik është bërë brenda tremujorit të vitit pasardhës dhe ka përdorur gjendjen *cash* në banesë në momentin e investimit. Shumën e investuar e ka tërhequr më pas nga depozita në “Raiffeisen Bank”, me qëllim rivendosjen e shumës së gjendjes *cash* për nevoja familjare të ditës.

Vlerësimi i trupit gjykues

135. Lidhur me sa më sipër është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse veprimi mund që të ishte regjistruar në sistemin bankar në një datë të mëvonshme (çka në këtë rast nuk ka ndodhur), ky regjistrim, gjithsesi, nuk do të impaktonte veprimin real të tërheqjes së kryer nga subjekti, e cila është kryer në datën 30.12.2005. Gjithashtu, duhet mbajtur në vëmendje faktin që deklarimi i gjendjes *cash* në banesë, ka për qëllim deklarimin e fondeve të disponuara fizikisht në banesë në formën *cash*, pra, *de facto*, pavarësisht regjistrimit të tyre në sistemin bankar. Edhe pse deklarimi i vitit 2005 është kryer në 3-mujorin e parë të vitit 2006, në lëvizjet bankare, tërheqja në fjalë është në fakt regjistruar me datën e kryerjes së veprimit, pra, më 30.12.2005, ku edhe daton realisht kryerja e veprimit.

136. Për rrjedhojë, bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet e dhëna nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato rezultojnë në tërësi jo bindëse, për aq kohë sa shpjegimet e dhëna nuk janë në harmoni dhe bien ndesh me provat dhe dokumentacionin e disponuar.
137. Ndërsa, sa i përket analizës financiare, si pasojë e pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit, të cilat do të trajtohen veçmas në trajtimin e rezultateve të analizës financiare, konkluzionet e njoftuara subjektit për këtë pikë, ndonëse në thelb nuk ndryshojnë, rezultati ka pësuar një pakësim minimal të balancës negative për krijimin e kursimeve *cash* në fund të vitit 2006, konkretisht nga vlera 552.492 lekë, që i ishte njoftuar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, përfundimisht rezulton në vlerën 545.891 lekë.

6. Depozitë kursimi e subjektit, në vlerën 15.335 euro, në BKT

138. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, kjo depozitë bankare është depozituar fillimisht *cash* në llogarinë e subjektit në BKT, prej këtij të fundit, në datën 30.12.2011, në shumën 15.000 euro, me përshkrimin “çelje nga Binas Nina, tërhequr nga ‘Credins Bank’ 7.000 euro + shitje apartamenti nr. certifikatë pronësie ***”. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar te shtesat “depozitë kursimi BKT”. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, por ka deklaruar pakësimet e depozitës në “Credins Bank”, në shumën 7.000 euro dhe shitjen e apartamentit në Librazhd.
139. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në fjalë nga: (i) tërheqje e shumës 7.000 euro nga depozita në “Credins Bank”, në datën 7.9.2011; (ii) të ardhura nga shitja e apartamentit të ndodhur në Librazhd në shumën 999.398 lekë; si dhe (iii) interesa bankare në shumën 335 euro. Nga shqyrtimi i llogarive bankare është konfirmuar tërheqja e shumës 7.000 euro, pjesë e depozitës prej 17.000 euro, trajtuar në pikën 5 të këtij relacioni.
140. ASHK-ja Librazhd, me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në emër të tij, pasurinë me nr. ***, vol ***, f. ***, z. k. ***, të llojit apartament me sip. 33.8 m², duke vënë në dispozicion dosjen e saj.
141. Ky apartament ka rezultuar të jetë përfituar prej subjektit me kontratën e shitjes me nr. *** prot., datë 3.4.1998, për privatizimin e banesës së ndodhur në ish-hoteli nr. ***, Librazhd, kundrejt vlerës 6.026 lekë. Ky apartament është shitur më pas nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. ***, datë 10.3.2011, vëllait G.N., kundrejt çmimit 999.398 lekë.
142. Pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, mbi pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse për të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë në fjalë, subjekti ka paraqitur mandatpagesën dhe formularin e përlllogaritjes së tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë. Subjekti bëri me dije, gjithashtu, se ky apartament nuk ka qenë i banuar për periudhën 1998 – 2011.
143. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

7. Gjendje në llogari rrjedhëse të subjektit, në vlerën 1.449.759 lekë, në “Raiffeisen Bank”

144. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo shumë është depozituar *cash* në llogarinë në “Raiffeisen Bank” të subjektit, prej këtij të fundit, në datën 11.10.2016,

shuma 1.450.000 lekë, me përshkrimin “të ardhura nga kursimet 2003 – 2014”. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar te shtesat depozitimin e shumës 1.450.000 lekë dhe ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në banesë me të njëjtën shumë.

145. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të njëjtin burim, duke specifikuar shtesat dhe pakësimet, ndër vite, përkatësisht: (i) në vitin 2004 – shtesë gjendje *cash* në banesë në shumën 800.000 lekë; (ii) në vitin 2005 – shtesë gjendje *cash* në banesë në shumën 300.000 lekë; (iii) në vitin 2006 - shtesë gjendje *cash* në banesë në shumën 300.000 lekë; (iv) në vitin 2007 – shtesë gjendje *cash* në banesë në shumën 1.200.000 lekë; (v) në vitin 2008 – pakësim gjendje *cash* në banesë në shumën 300.000 lekë; (vi) në vitin 2009 – pakësim gjendje *cash* në banesë në shumën 1.200.000 lekë; (vii) në vitin 2010 – shtesë gjendje *cash* në banesë në shumën 400.000 lekë.
146. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka shtuar, gjithashtu, se shtesat e deklaruara prej tij kanë qenë nga të ardhurat nga pagat, me përjashtim të vitit 2007, ku në shumën 1.200.000 lekë të shtuara, shuma 1.000.000 lekë ka qenë nga të ardhurat nga dëmshpërblimi.
147. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike, ndër vite dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit sa i përket gjendjes së disponuar *cash* në banesë, ka rezultuar se në vitin 2007, subjekti ka deklaruar shtesë *cash* (lekë në banesë) vetëm shumën 200.000 lekë dhe jo shumën 1.200.000 lekë. Ndërsa, shuma 1.000.000 lekë nga kundërshpërblimi, është deklaruar prej subjektit vetëm në rubrikën e të ardhurave të vitit, pa u specifikuar mbartja e kësaj shume.
148. Nga viti 2011 dhe në vijim, subjekti nuk ka deklaruar më ndryshime të gjendjes së disponuar *cash* në banesë, deri në vitin 2016, kur është deklaruar depozitimi i shumës prej 1.450.000 lekësh (nga 1.500.000 lekë të disponuara në fund të vitit 2015), në llogarinë në “Raiffeisen Bank”.
149. Ndërkohë, në analizën e kryer nga Komisioni, në referencë të vetëdeklarimeve të subjektit, gjendja e disponuar në fund të vitit 2015, duket të ketë qenë vetëm 500.000 lekë, për sa kohë mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit i mbartjes së shumës prej 1.000.000 lekësh në vitin pasardhës, prezumon shpenzimin e kësaj shume brenda vitit të deklarimit.
150. Në vijim të sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 950.000 lekë, për të kryer depozitimin e shumës në analizë, në vitin 2016.
151. Por edhe në rast se nga Komisioni do të pranohej pretendimi i subjektit, për kursimin e shumës 1.000.000 lekë nga dëmshpërblimi në vitin 2007, për sa kohë të ardhurat në këtë shumë nuk janë konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm, njohja e këtij kursimi në vitin 2007 do të përmirësonte balancën e vitit 2016 dhe do të përkeqësonte balancën e vitit 2007 me të njëjtën shumë dhe, për pasojë, rezultati i analizës financiare do të mbetej i njëjtë.
152. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 950.000 lekë, për kryerjen e depozitimit të shumës 1.450.000 lekë në llogari nga kursimet e disponuara *cash* në banesë, në “Raiffeisen Bank”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

153. Në prapësimet e paraqitura, subjekti ka mbajtur qëndrimin se shuma 1.000.000 lekë, ka qenë me burime të ligjshme dhe se kjo shumë është për një dëm të prekshëm dhe të mundshëm real, ku vlera e dëmshpërblimit është përcaktuar me marrëveshje mes palëve ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit.
154. Lidhur me deklarimin e kësaj shume në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka pretenduar se nga Komisioni nuk është lexuar qartësisht deklarimi periodik vjetor i këtij viti, pasi në deklarimin e vitit 2007 dhe 2008, provohet përtej çdo dyshimi se shuma 1.000.000 lekë ka qenë gjendje *cash*. Gjithashtu, subjekti me prapësimet e depozituara ka bashkëlidhur edhe dokumentin “*deklaratë drejtuar ILDKPKI-së*” që daton më 25.3.2009, nga ku sipas subjektit provohet sipas shënimit në të se i ka kërkuar Inspektoratit që shuma 1.000.000 lekë të cilën e kishte marrë prej shtetasit E.K., si kundërshtëpërblim është deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 me emërtimin “bono thesari BKT”, duke kërkuar që të mbaje emrin “shtesë lekësh gjendje në banesë”, fakt ky, që sipas tij provon faktin se shuma e sipërcituar ka qenë gjendje në banesë.

Vlerësimi i trupit gjykues

155. Lidhur me pretendimin se subjekti ka depozituar deklaratë pranë Inspektoratit, lidhur me saktësimin e kësaj shume, Komisioni vëren se kjo deklaratë nuk përmban elementët formalë të depozitimit pranë këtij institucioni, pasi nuk është e pajisur me nr. protokolli, datë, vit, si dhe informacioni dhe saktësimi i kërkuar nga subjekti nuk është reflektuar në deklarimin pasardhës të subjektit, sikurse ka ndodhur për raste të tjera. Gjithsesi, Komisioni vlerëson të theksojë se në të gjitha rastet, për sa kohë nuk janë konsideruar si të ligjshme të ardhurat në masën 1.000.000 lekë nga dëmshpërblimi (pikë e trajtuar më sipër), njohja e kursimeve në vitin 2007 do të krijonte të njëjtën balancë negative në vitin 2007, duke bërë që rezultati total i analizës financiare të mos ndryshonte edhe nëse do të merrej në konsideratë ky version i pretenduar nga subjekti.

8. Llogari kursimi e subjektit, në vlerën 5.595 USD, në Westfargo Bank, në SHBA

156. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë llogari, për herë të parë, në vitin 2011 për depozitimin e shumës 925 USD, më pas, në vitin 2012 është deklaruar shtesa e shumës prej 3.415 USD në këtë llogari dhe në vitin 2016 është deklaruar shtesa me shumën 1.256 USD.
157. Në Deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar depozitimet me burim nga të ardhurat nga rimbursimi i taksave si rezidentë në SHBA, nga lëvizjet e llogarisë të depozituara konfirmohet rimbursimi i shumës 1.800 USD në vitin 2012, transferuar në këtë llogari, në datë 12.12.2012, por ndërkohë shtesa e deklaruar në këtë vit prej subjektit është në shumën 3.415 USD. Më pas, janë paraqitur lëvizjet e llogarisë, për periudhën 26.10.2016 – 31.12.2016, mes të cilave duket se është transferuar një shumë prej 2.000 USD, për rimbursim të taksave në datën 7.12.2016, shumë e cila është tërhequr më pas, përkatësisht 1.000 USD, datë 12.12.2016 dhe 1.000 USD, datë 19.12.2016.

158. Për sa kohë, të ardhurat e përfituara nga rimbursimi i taksave në vitin 2016, duket të jenë tërhequr në dhjetor të vitit 2016⁴⁶ dhe, për rrjedhojë, duket se shtesa e deklaruar prej subjektit në këtë llogari, së paku ajo e vitit 2016, nuk ka si burim këto të ardhura.
159. Gjithashtu, për sa kohë këto të ardhura, në shumën 2.000 USD, ndonëse duket të jenë përfituar, janë tërhequr prej dikujt jashtë familjes së subjektit dhe, për pasojë, nuk kanë kontribuar në ekonominë familjare të subjektit për vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën financiare të vitit 2016, si të ardhura të përfituara. Gjithashtu, duket të mos jenë paraqitur lëvizjet e plota të kësaj llogarie në emër të subjektit në SHBA, për të kryer një verifikim dhe kontroll të plotë të lëvizjeve të saj, nga momenti i çeljes në vitin 2011.
160. Për pasojë, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës mbi sa vijon:
- Në përfundim të sa më sipër, duket se nuk janë paraqitur lëvizjet e plota të kësaj llogarie në emër të subjektit në SHBA, nga momenti i çeljes së saj, në vitin 2011.
 - Gjithashtu, mbetet e paqartë dinamika e përfitimit të rimbursimit të taksave, si dhe sa kanë qenë shumat/vlerat e paguara si tatime në funksion të përfitimit më pas, të rimbursimit të deklaruar.
 - Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime bindëse dhe të detajuara, për sa më lart, si dhe të paraqesë dokumentacionin ligjor lidhur me: (i) fitimet/ të ardhurat e gjeneruara në SHBA; dhe (ii) tatimet përkatëse të paguara - që kanë mundur përlllogaritjen e rimbursimit tatimor të përfituar nga ana juaj.
 - Referuar sa më sipër përshkruar, Komisioni vlerëson se duket se nuk janë provuar burimet e ligjshme të të ardhurave, që kanë mundur shtesat e deklaruar në këtë llogari, së paku në vitet 2011, 2012 dhe 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

161. Në prapësimet e depozituara, subjekti është shprehur se nuk ka ushtruar aktivitet punësimi apo siguruar të ardhura nga paga në SHBA, në mënyrë që të paguajë tatime apo taksa, por se duke qenë rezident në SHBA, familja e tij dorëzon çdo vit pranë zyrave përkatëse vërtetimet për të ardhurat në Shqipëri. Ligji amerikan i trajton në të njëjtën mënyrë shtetasit amerikanë që jetojnë brenda dhe jashtë Amerikës dhe pasi ka studiuar nivelin e të ardhurave të familjes në Shqipëri ka vlerësuar se nuk janë në nivelin minimal të të ardhurave që shteti amerikan ka përcaktuar për qytetarët dhe rezidentët në SHBA. Në këto kushte, ka kualifikuar fëmijët për kredi shtesë të taksës në masën 1.000 USD, për çdo fëmijë/për çdo vit. Çeqet kanë ardhur në adresën e regjistruar në Amerikë, te vëllai I.N., ku është dhe adresa e rezidencës së subjektit në SHBA. Subjekti dhe pjesëtarët e familjes në vitin 2016 nuk kanë qenë në Amerikë, por çeqet janë marrë nga i vëllai I.N. dhe janë dërguar.

Vlerësimi i trupit gjykues

162. Lidhur me sa më sipër, Komisioni vëren se nga formularët e rimbursimit të taksave të paraqitura për vitet 2013, 2014 dhe 2015, duket se është paguar taksa në masën 2.000 USD/vit dhe, më pas, për shkak të të ardhurave nën limitin e taksueshëm, i është miratuar rimbursimi i

⁴⁶Periudha muaj/vit në të cilin, nga sistemi *TIMS*, si dhe deklarimet e subjektit, ai dhe personat e lidhur me të nuk duket të ketë qenë në SHBA.

tyre. Për pasojë, duket se nuk ka pasur të ardhura të tjera në SHBA, por minimalisht ka pasur një shpenzim vjetor prej 2.000 USD.

- 163.Lidhur me lëvizjet bankare, ato serish nuk janë paraqitur të plota edhe pas kalimit të barrës së provës, pasi ka lëvizje ndërmjet periudhave të paraqitura, të paevidentueshme, së paku një diferencë prej rreth 500 USD nga viti 2013 në vitin 2014 dhe rreth 2.300 USD nga viti 2015 në 2016.
- 164.Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit, ndonëse është pyetur konkretisht mbi të dy çështjet e mësipërme ka dështuar të paraqesë lëvizjet e plota, të qarta duke lenë paqartësi nga ana e tij, lidhur me lëvizjet bankare, menaxhimin e tyre dhe mbi shpenzime të mundshme për taksa të paguara në SHBA. Gjithsesi, kjo pikë në vetvete nuk mund të përbëjë shkak ndëshkues për subjektin, për sa kohë nuk janë konstatuar të ardhura, fitime apo pasuri të tij apo familjarëve të tij, në SHBA, të padeklaruar në ILDKPKI.

9. Gjendje në llogarinë e subjektit, në vlerën 4.020 USD, në “Intesa Sanpaolo Bank”

- 165.Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë llogari për herë të parë në deklaratën *Vetting*, me burim nga të ardhurat nga kthimi/rimbursimi i taksave si rezidentë të SHBA, në shumën 4.000 USD të kthyer në vitin 2016 nga taksat e vitit 2013 dhe 2014. Këto të ardhura janë deklaruar prej subjektit edhe në DIPP-në e vitit 2016, në shumën totale 6.000 USD, përfshirë dhe 2.000 USD të trajtuara më lart në pikën 8 të këtij relacioni.
- 166.Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se shuma prej 4.000 USD është depozituar nëpërmjet dy çeqeve, prej 2.000 USD secila, në datë 9.1.2017, në llogarinë e përbashkët të subjektit dhe të bashkëshortes në “Intesa Sanpaolo Bank, me përshkrimet përkatëse “tax refund 12/2013 dhe 12/2014”.
- 167.Ndonëse këto të ardhura janë deklaruar prej subjektit në DIPP të vitit 2016, ato duket se janë përfituar/transferuar realisht në ekonominë familjare në vitin 2017 e për rrjedhojë ato nuk janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2016.
- 168.Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit dhe deklarimin e llogarisë në analizë.

10. Depozitë kursimi, në vlerën 1.430.729 lekë, në BKT, në emër të bashkëshortes së subjektit

- 169.Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo shumë është krijuar nga: (i) shuma 500.000 lekë e investuar në datën 30.12.2013; (ii) shuma 500.000 lekë në datën 30.12.2014; si dhe (iii) shuma 400.000 lekë në datën 30.12.2015. Këto shuma janë shtuar me të ardhurat nga interesat dhe në datën 30.12.2015 është investuar shuma totale 1.430.729 lekë në depozitë me afat.
- 170.Në deklaratën e personit të lidhur në DIPP-të e viteve 2013, 2014 dhe 2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shtesat përkatëse si më lartpërshkruar. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare, ka rezultuar se të tri shumat përbërëse të depozitës në analizë, janë transferuar çdo fundvit nga llogaria e pagës së bashkëshortes së subjektit në llogarinë e depozitës. Konstatohet se në këto tri vjet (2013-2015) bashkëshortja e subjektit nuk i ka

tërhequr të ardhurat e saj nga paga, por ato janë akumuluar në llogari deri në fund të vitit përkatës dhe më pas janë kaluar në depozitë.

171. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

11. Depozitë për pension në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit

172. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo shumë i është transferuar bashkëshortes së subjektit, nga llogaria e pagës së këtij të fundit në datën 9.1.2017, për “***”, me burim nga të ardhurat e tij nga paga.

173. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

12. Gjendje në llogarinë e pagës së bashkëshortes, në shumën 37.240 lekë, në BKT

174. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo shumë rrjedh nga paga e bashkëshortes së subjektit, transferuar në janar të vitit 2017.

175. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

13. Gjendje në llogari rrjedhëse të bashkëshortes, në shumën 792 lekë, në “Raiffeisen Bank”

176. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo shumë është mbetja në llogari nga të ardhurat si punonjëse akademike e jashtme në universitetin “A*** Xh***”, Elbasan, për periudhën 2015 – 2016⁴⁷.

177. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

14. Depozitë kursimi, në shumat 42.729 lekë dhe 567 euro, në BKT, në emër të vajzës F.N., si dhe depozitë kursimi, në shumat 42.729 lekë dhe 567 euro, në BKT, në emër të djalit K.N.

178. Këto depozita janë çelur përkatësisht: në vitin 2008, shuma 30.000 lekë për secilin fëmijë; në vitin 2010, shuma 500 euro për secilin; si dhe janë shtuar me të ardhurat nga interesat, ndër vite, përkatësisht në shumat 12.729 lekë dhe 67 euro.

179. Në DIPP-të përkatëse, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të shumave të mësipërme të fëmijëve të tij nga kursimet e tyre. Në deklaratën *Vetting*, subjekti është shprehur se burimet e krijimit kanë qenë nga dhuratat e ditëlindjeve dhe të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes.

180. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e krijimit të depozitës në fjalë.

⁴⁷Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 9.1.2017, të lëshuar nga universiteti “A*** Xh***”, Elbasan, bashkëshortja e subjektit ka përfiturar të ardhura *bruto* në shumën 72.000 lekë, nga të cilat *neto* 61.200 lekë. Kjo shumë i është transferuar në llogari, në datën 7.12.2016, nga të cilat ka tërhequr shumën 60.000 lekë dhe pas zbritjes së komisioneve bankare ka mbetur gjendje në llogari shuma e deklaruar prej 792 lekë.

15. Huadhënie në shumën 3.500.000 lekë

181. Në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar dhënien e huas pa interes dhe pa afat të përcaktuar në shumën 3.500.000 lekë, vjehrrit, z. I.B.⁴⁸, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 30.12.2009, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume.
182. Kontrata e huas me referencat e sipërcituara është nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huadhënësit dhe vjehrrit të tij në cilësinë e huamarrësit, në datë 30.12.2009, ku palët kanë deklaruar se në datën e nënshkrimit është dhënë shuma 3.500.000 lekë, jashtë zyrës noteriale. Kjo huadhënie është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën *Vetting*, me burim krijimi nga: (i) tërheqja e depozitës në BKT, në shumën 1.605.553 lekë, në datën 5.10.2009, e krijuar kjo shumë nga kalimi i bonos së thesarit; (ii) pakësimi i gjendjes së disponuar *cash* në banesë në shumën 1.200.000 lekë; si dhe (iii) të ardhurat e vitit 2009.
183. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të bërë me dije nëse kjo shumë është kthyer nga huamarrësi. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se kjo shumë ende nuk i është kthyer.
184. Lidhur me këtë huadhënie, përveç problematikave të konstatuara në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, ndër vite, sa i përket gjendjeve të disponuara *cash* në banesë, nga Komisioni nuk është hetuar/analizuar, më tej, për sa kohë kjo shumë ende nuk është kthyer pas nga huamarrësi dhe, për pasojë, ende nuk është pjesë e pasurive/të ardhurave të subjektit.
185. Megjithatë, nga një analizë e kryer nga Komisioni, lidhur me burimet e deklaruara prej subjektit, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, në total në shumën 716.002 lekë⁴⁹.

16. Gjendje *cash* në banesë, në shumën 450.000 lekë

186. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e kursimeve *cash* të disponuara në banesë, në datën 31.12.2016, në shumën 450.000 lekë, ka deklaruar dhe burimin e krijimit të kësaj shume, përkatësisht në shumën 400.000 lekë nga të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes së vitit 2016, si dhe shumën 50.000 lekë të mbetura pas depozitimit të shumës 1.450.000 lekë në llogari. Sa i përket shumës 50.000 lekë, në vijim të analizës financiare, duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për disponimin e gjendjes *cash*.
187. Komisioni, gjithashtu, ka kryer analizën financiare, mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për të krijuar kursime në shumën 400.000 Lekë, duke përfshirë të ardhurat e vitit 2016, në përfundim të së cilës ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën 20.062 lekë, të detajuar në vijim.

⁴⁸Referuar në kontrollin e kryer në faqen zyrtare të QKB-së, nuk ka rezultuar regjistrimi i ndonjë aktiviteti tregtar nga ky shtetas.

⁴⁹Nga analiza financiare ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, prej së paku -183.748 lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet dhe kursimet e pretenduara në vitin 2007, pas investimit në bono thesari. Po ashtu, ka rezultuar një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej së paku -245.549 lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet dhe kursimet e pretenduara në vitin 2008, pas investimit në bono thesari, si dhe një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -286.705 lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet e familjes dhe dhënien e shumës 700.000 lekë, me të ardhurat e vitit 2009. Ndonëse subjekti nuk i është kaluar barra e provës për këtë rezultat, pas prapësimeve të paraqitura prej subjektit dhe pas pranimit të disa prej pretendimeve të tij, ky rezultat do të ulej në -637.978 lekë.

Tabela nr. 8 – Analiza për kursimet e vitit 2016

Të ardhura nga pagat 1.1.2016 - 31.12.2016		1 898 900
Shpenzime të familjes 1.1.2016 - 31.12.2016	-	1 518 962
Kursime cash në banesë me të ardhurat e vitit	-	450 000
Rezultati	-	70 062

188.Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 70.062 lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet e familjes dhe krijimin e kursimeve në shumën 450.000 lekë, në vitin 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

189.Subjekti është shprehur në prapësimet e tij se kjo mungesë ka ardhur kryesisht si pasojë e mosnjohjes së të ardhurave në shumën 1.000.000 lekë, të përfituara si dëmshpërblim nga shtetasi E.K.

Vlerësimi i trupit gjykues

190. Sikurse është konkluduar edhe më sipër, në vijim të analizimeve të mësipërme mbi përfitimin e shumës 1.000.000 lekë dhe mungesën e legjitimitetit të përfitimit të saj, Komisioni çmon se rezultati edhe për këtë pikë nuk ndryshon, por balanca negative ulet duke arritur në vlerën 48.032 lekë, si pasojë e pranimit të disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të dokumentuara në prapësimet e paraqitura, lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të familjes së tij, të cilat do të specifikohen si ndryshime me vlerat përkatëse, në kapitullin e rezultateve të analizës financiare.

17. Konstatime të tjera

17.1 Të ardhura nga vendimi nr. *, datë 25.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**

191.Nga shqyrtimi i DIPP-së së viteve 2017 dhe 2018, subjekti ka deklaruar të ardhura, përkatësisht në masat 1.500.000 lekë dhe 1.599.174 lekë, për *shkaktim dëmi pasuror e jo pasuror* nga shoqëria e sigurimeve “***” sh.a., sipas vendimit nr. ***, datë 25.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Po ashtu, nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit janë konfirmuar transfertat e kryera nga shoqëria “***” sh.a. në favor të subjektit, si në vijim: (i) vlera 1.500.000 lekë në datën 18.12.2017; (ii) vlera 799.174 lekë në datën 16.2.2018; dhe (iii) vlera 800.000 lekë në datën 16.4.2018.

192.Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bëjë me dije lidhur me dinamikën e ngjarjes, duke paraqitur gjithashtu dokumentacionin ligjor, në bazë të të cilit është vendosur dhënia e dëmshpërblimit, përfshirë edhe praktikën e plotë të dëmshpërblimit dhe të vendimit/eve të gjykatës. Komisioni i ka kërkuar subjektit gjithashtu të bëjë me dije mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave për palët e përfshira.

193.Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Në lidhje me dëmet materiale e shëndetësore, sqaroj se unë nuk kam pasur dëme materiale, pasi mjeti në të cilin kam udhëtuar nuk është mjeti im, nuk kam qenë drejtues i mjetit, por mjeti ka qenë në emër të

shtetasit L.B.⁵⁰. Përveç meje, që kam pësuar dëmtime shëndetësore, pasi më është thyer totalisht krahu i djathtë dhe ka pasur lëvizje të shpatullës (që ka lidhje me shëmtimin), nuk ka pasur person tjetër dëmtim shëndetësor. Unë jam trajtuar në Spitalin e Elbasanit. Familjarët e mi kanë përfutur dëmshpërblim sipas ligjit për dëmin moral dhe ekzistencial që kanë pësuar si pasojë e aksidentimit të familjarit të tyre. Pronësia e mjetit me targa ***, sipas lejes së qarkullimit është në emër të shtetasit A.N.L., nuk e njoh këtë person dhe nuk kam asnjë lidhje me të. Nuk di që të kem pasur konflikt të mundshëm interesash⁵¹ me shtetasen N.M.⁵², shoqërinë ‘***’ sh.a., si dhe ortakët e saj. Për shkak se çështja u zgjidh me marrëveshje me mirëkuptim, unë nuk kam kryer raport ekspertimi me ekspertë mjeko-ligjorë për të paraqitur në gjykatën civile”.

194. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua shoqërisë “****” sh.a., me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.7.2021, duke i kërkuar të paraqesë marrëveshjen e zgjidhjes me mirëkuptim, policat e sigurimit, procesverbalet e aksidentit të ndodhur në datën 15.7.2017, vlerësimet e dëmit/eve të shkaktuar/a, si dhe raportin e ekspertëve të cilët kanë përcaktuar vlerën e dëmit pasuror dhe jo pasuror në masën 3.099.174 lekë, subjektit të rivlerësimit. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.8.2021, shoqëria “****” sh.a. ka paraqitur: marrëveshjen për zgjidhjen me mirëkuptim; policat e sigurimit të dy automjeteve të përfshira në aksident; aktin e ekspertimit auto-teknik datë 15.5.2017; si dhe vlerësimin mjeko-ligjor dhe aktvlerësimin financiar.
195. Nga dokumentacioni i paraqitur dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka rezultuar se me vendimin e grupit të ekspertëve siguroes nr. *** prot., datë 6.9.2017, është vendosur se: “Pacienti përfiton paaftësi të përhershme në masën 20 %, duke filluar nga data e aksidentit”.
196. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 25.10.2017, ka vendosur: “Lëshimin e urdhrat të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 25.10.2017, për miratimin e zgjedhjes me pajtim të mosmarrëveshjes dhe detyrimin e të paditurit ‘***’ t’i paguajë Binas Nina dëmin jo pasuror⁵³ të pësuar si aksident të datës 15.5.2017, të shumës prej 3.099.174 lekësh”.
197. Ndërkohë, me vendimin nr. ***, datë 23.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendosur “mosfillimi i procedimit penal” ndaj shtetasës N.M. Nga shqyrtimi i vendimit të sipërcituar rezulton se për kryerjen e një hetimi sa më të plotë është kryer ekspertimi mjeko-ligjor dhe auto-teknik, me qëllim përcaktimin e shkallës së dëmtimeve të shtetasit Binas Nina, si dhe shkakun e kryerjes së aksidentit. Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 18.5.2017, rezulton se: “Tek i dëmtuari Binas Nina konstatohet trauma automobilistike, frakturë e krahut të djathtë e i mobilizuar me allçi, dëmtime të shkaktuara me mjet mprehës, dëmtime të cilat hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar humbje të aftësisë

⁵⁰Nga kontrolli në faqen zyrtare të AMF-së konstatohet se shtetasi L.B. është pronar i vetëm i automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** dhe se subjekti i rivlerësimit Binas Nina, referuar të dhënave në TIMS nuk ka udhëtuar dhe nuk ka qenë përdorues i automjetit në fjalë.

⁵¹Subjekti i rivlerësimit nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues për të provuar mospasjen e konfliktit të interesit me shtetasin N.M. dhe A.L., si dhe shoqërinë “****” sh.a. dhe ortakët e tij, pohime të cilat mbeten në nivel deklarativ.

⁵²Shtetasja që në momentin e aksidentit drejtonte automjetin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 12.8.2021, ka bërë me dije se rezulton se kjo shtetase është në proces gjykimi penal me objekt “dërgim në gjyq”, me gjyqtar T.T., ku prokuror i çështjes është E.T.

⁵³Referuar ligjit nr. ***, datë 12.2.2006, “Për sigurimin e detyrueshëm në Sektorin e Transportit”, në rregulloren nr. ***, datë 25.6.2009, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - Bordit, ku përllogaritja e dëmshpërblimit (D), dëmshpërblimi (Dp), dëmi pasuror + (Djp) dëmi jo pasuror + (v) shpenzime spitalore.

në masën mbi nëntë ditë dhe se këto dëmtime klasifikohen si 'plagosje e lehtë', e në këto rrethana, për shtetasen N.M. është vendosur 'mosfillimi i procedimit penal'".

198.Nga sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionin se duket se ka mospërputhje midis përcaktimit të humbjes së paaftësisë së përhershme në masën 20 %, rezultat i grupit të ekspertëve, me çka është pasqyruar në raportin mjeko-ligjor të datës 18.5.2017, të përmendur në vendimin e prokurorisë, i cili ka klasifikuar dëmtimin në fjalë si “plagosje e lehtë”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

199.Subjekti ka mbajtur qëndrimin se edhe sipas dokumentacionit të disponuar, por edhe nga ai i vënë në dispozicion me anë të prapësimeve, nuk ka asnjë mospërputhje mes kategorizimeve si plagosje e lehtë për dëmtime që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën 20 %.

Vlerësimi i trupit gjykues

200.Referuar dokumentacionit të disponuar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore, Komisioni arrin në konkluzionin se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë plotësisht bindëse, pasi ato rezultojnë kontradiktore lidhur me masën e dëmtimit të vlerësuar nga ekspertët dhe masën e përfitimit ekonomik nga subjekti, duke ngjasuar më shumë me veprime të cilat janë kryer në mënyrë favorizuese, me qëllim përfitimin e një dëmshpërblimi më të lartë se dëmi i shkaktuar.

201.Komisioni arrin në përfundimin se midis akteve të ekspertizës të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila e ka cilësuar si “plagosje të lehtë”, dhe aktit të ekspertizës që ka cilësuar subjektin se “përfiton paaftësi të përhershme në masën 20 %, duke filluar nga data e aksidentit”, ka mospërputhje të dukshme të niveleve të ndryshme të përcaktimit të masës së dëmtimit – ndonëse ndaj shoqërisë së sigurimit nuk u vërejt ndonjë konflikt interesi ku subjekti të kishte përfaqësuar organin e prokurorisë me këtë palë, mbetet dyshimi se subjekti ka përfituar për shkak të funksionit më shumë dëmshpërblim nga sa realisht ishte dëmtuar.

202.Nisur nga sa më sipër – si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe dëmshpërblimin e pretenduar prej 1.000.000 lekësh për një dëm të pa pësuar, si dhe diferencat e çmimit të mjeteve motorrike pa logjikë ekonomike – trupi gjykues krijon bindjen e brendshme se veprimet dhe qëndrimet e subjektit përkojnë me përpjekje për të gjeneruar dhe mundësuar vlerësime maksimale të përfitimit të tij, edhe përtej çka mund t'i takonte, në kapërcim të dukshëm të logjikës ekonomike dhe në mungesë të harmonisë së logjikshme midis provave të dëmeve/vlerave ekzistuese dhe dëmshpërblimeve apo çmimeve të përfituara, çojnë në konkluzionin se ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe që, kështu, këto fakte duhet të mbahen në vëmendje, në aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në gërshetim edhe me konstatimet e tjera.

18. Dhurime të deklaruara ndër vite

203.Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Të ardhura të dërguara nga vëllai I.N. nga SHBA, nëpërmjet bankës apo Western Union, në vlerat 4.310 USD dhe 626 USD gjatë viteve 1998 - 2010*”. Subjekti i ka deklaruar këto dhurime edhe në DIPP-të përkatëse ndër vite.

Pasi është kërkuar nga Komisioni të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruesit, subjekti ka paraqitur një deklaratë të lëshuar⁵⁴ nga vëllai i tij në SHBA, në të cilën është shprehur se për shkak të afatit mbi 10 vjet nga momenti i dërgimit të parave, nuk mund të marrë informacionin e taksave të raportuara për vitet 1998 - 2010.

204.Po ashtu, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “Dërgesa nga shtetasit Y.B., A.B. dhe B.S.⁵⁵, përkatësisht vëllezërit dhe kushëriri i bashkëshortes, përkatëse në shumat 346 euro, 396 euro dhe 846 USD”. Për të tre këta shtetas, subjekti ka paraqitur deklaratimet e tyre noteriale, që konfirmojnë dërgimin e parave, por për shkak të largimit të tyre nga Mbretëria e Bashkuar nuk mund të paraqesin dokumentacionin e kërkuar për të provuar burimin e ligjshëm të shumave të dhuruara.

205.Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruesve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

206.Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara, ka depozituar dokumentacionin lidhur me të ardhurat e vëllait të tij I.N. Ndërsa, sa u takon dokumentacionit që provon burimin e ligjshëm të dhurimit nga shtetasit Y. B., A. B. dhe B. S., ai ka shpjeguar se është në pamundësi për shkak të kohës dhe faktit se këta shtetas kanë humbur statusin e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe, për rrjedhojë, e ka të pamundur të sigurojë dokumentacionin e kërkuar.

207.Megjithatë, ai ka vënë në dispozicion disa dërgesa nga Western Union, duke shtuar se këto shuma nuk janë me vlera të larta dhe se nuk ka fshehur asgjë.

Vlerësimi i trupit gjykues

208.Komisioni ka përfshirë në analizën financiare, të kryer për subjektin e rivlerësimit, dhurimet e kryera nga vëllai i tij, të dërguara nga SHBA-ja nëpërmjet institucioneve financiare. Për sa i përket dhurimeve të kryera nga personat e tjerë, ato nuk janë përfshirë në analizë financiare, si pasojë e mospërbushjes së detyrimit ligjor për provimin e burimit të ligjshëm të dhuruesve, ndonëse i është kërkuar nga Komisioni. Megjithatë, Komisioni thekson se këto dhurime, në të gjitha rastet, nuk janë në shuma të konsiderueshme dhe nuk do të mund të ndryshonin ndjeshëm rezultatin financiar dhe, për rrjedhojë, as vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

209.Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga

⁵⁴Jo në formën e kërkuar nga ligji.

⁵⁵Deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.8.2021, e shtetasit Y.B.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.8.2021, e shtetasit A.B.; si dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.8.2021.

burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – sikurse është detajuar dhe arsyetuar më sipër përgjatë analizimit të pretendimeve të subjektit mbi zërat specifike të analizës financiare në raport me rezultatet e njoftuara nga Komisioni.

210. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit Binas Nina nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara, pasi për periudhën 2003 – 2016 ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën 4.564.957 lekë, për të cilën Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura lidhur me kriterin e pasurisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

211. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare të kryer nga një ekspert, në të cilën ka rezultuar një balancë negative në masën 319.470 lekë, për periudhën 2003 – 2016. Përveç sa më sipër trajtuar në analizimin e pasurive veçmas, subjekti ka parashtruar pretendimet, si vijon:

- ka kërkuar që shpenzimet e mobilimit të vendosen në masën 300.000 lekë në vitin 2003 dhe jo të shpërndara në vitet 2004, 2005 dhe 2006, pasi në vitin 2003 ka kryer pjesën më të madhe të shpenzimeve për të filluar banimin;
- ka kërkuar që për vitet 2004 dhe 2005 të zbriten shpenzimet e jetesës së fëmijëve, pasi, duke qenë të vegjël, kanë jetuar me vjehrit;
- ka kërkuar të zbriten shpenzimet e udhëtimit në masën 50 - 58 euro për transportin në udhëtimet me automjetet e shtetasve S.Q. dhe S.N.⁵⁶, sipas deklaratës noteriale, në të cilën ka bërë me dije se gjatë këtyre udhëtimeve me automjetin e tij subjekti nuk ka paguar shpenzime transporti;
- ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. ***, datë 9.11.2021, të lëshuar nga shtetasja B.M.⁵⁷, e cila ka deklaruar se në udhëtimin familjar të kryer në datat 17.8.2014 – 24.8.2014, me destinacion Selanikun, Greqi, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë qëndruar në banesën e saj dhe shpenzimet e tyre për fjetje dhe ushqim janë mbuluar prej saj;
- ka kërkuar të korrigjohet kohëzgjatja e një udhëtimi nga 7 ditë në 2 ditë;
- ka kërkuar të zbriten shpenzimet e udhëtimit për vitin 2012, në masën 3.503 euro, pasi janë paguar nga vëllai i subjektit, duke paraqitur rezervimet dhe mandatet e pagesave të kryera me kartën e kreditit të shtetasit I.N.

Vlerësimi i trupit gjykues

212. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të subjektit, janë sistemuar pretendimet e tij lidhur me shpenzimet e udhëtimeve me automjetet e shtetasve S.Q. dhe S.N., si dhe udhëtimi 2-ditor.

213. Lidhur me udhëtimin familjar me destinacion Selanikun, Greqi, trupi gjykues ka pranuar pretendimin e subjektit, duke ulur shpenzimet e qëndrimit në këtë udhëtim, në masën 5

⁵⁶Nr. ***, datë 8.11.2021.

⁵⁷Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës noteriale kartën e identitetit shqiptare dhe atë greke të deklaruases.

euro/dita, pasi ky deklarim përputhet edhe me deklarimin e kryer në përgjigje të pyetësorit nr. 1 nga subjekti i rivlerësimit, mbi qëndrimin e familjes së tij te kushërira e bashkëshortes.

- 214.Sa i përket pretendimit të subjektit, të parashtruar edhe në seancën dëgjimore, për uljen e shpenzimeve të udhëtimeve familjare të kryera me destinacion qytetet e Maqedonisë së Veriut, Komisioni vlerëson se në mungesë të provës së kundërt mbi shpenzimet e realizuara nëpër këto udhëtime, t'i qëndrojë metodologjisë së përdorur nga Kolegji, në vendimin nr. 11/2019 (JR).
- 215.Sa i përket shpenzimeve të mobilimit, nuk është pranuar pretendimi i subjektit në prapësime, për sa kohë është në kundërshtim me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe 2, në të cilat është pyetur dhe ka kthyer përgjigje që blerjet janë bërë ndër vite dhe nuk e mban mend shumën e shpenzuar në çdo vit.
- 216.Sa i përket pretendimit për uljen e shpenzimeve të jetesës së fëmijëve, ky pretendim nuk është pranuar nga trupi gjykues, për sa kohë nuk është deklaruar apo pretenduar prej subjektit në ndonjë moment përgjatë procesit të rivlerësimit.
- 217.Është konsideruar pretendimi i subjektit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për në SHBA në vitin 2012, sipas provave të paraqitura për kryerjen e rezervimit dhe mandatit të pagesave të kryera nga shtetasi I.N., ndonëse në DIPP-në e vitit 2012 subjekti nuk e ka deklaruar përfitimin e kësaj dhurate, përtej limitit të deklarueshëm.
- 218.Në përfundim të sa më sipër, pas përfshirjes në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, ka rezultuar një balancë negative në masën 3.440.634 lekë, të detajuar në aneksin nr. 1 si më poshtë vijon dhe, për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se në këtë rast duhet të aplikohet edhe pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Aneksi nr. 1 - Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	910 000	940 068	214 037	1 314 376	770 153	845 468	-2 615 694	678 063	1 151 001	842 064	992 943	629 578	375 686	1 481 757
Apartament 30 m ² në Librazhd														
Apartament 106 m ² në L. 28 N***, Elbasan										300 000				
Automjet me targë EL***	350 000													
Automjet me targë AA***HF											600 000			
Tokë arë (përfitur me L. 7501), 1/6														
Tokë arë (përfitur me L. 7501) e b/sh, 1/4														
Ndryshim likuiditeti	560 000	940 068	214 037	1 314 376	770 153	845 468	-2 615 694	678 063	1 151 001	542 064	392 943	629 578	375 686	1 481 757
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1 060 000	2 000 068	2 214 105	3 528 481	4 298 634	5 144 102	2 528 408	3 206 471	4 357 471	4 899 536	5 292 478	5 922 057	6 297 742	7 779 500
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	910 000	940 068	214 037	1 314 376	770 153	845 468	-2 615 694	678 063	1 151 001	842 064	992 943	629 578	375 686	1 481 757
Të ARDHURA dokumentuar	2 820 687	1 021 980	1 018 166	1 202 787	1 306 004	1 447 578	1 561 633	1 638 458	2 628 346	1 727 982	1 880 241	1 728 343	1 815 347	1 958 063
Të ardhura të SR të vërtetuara	2 683 382	872 231	848 745	995 018	1 063 060	1 167 340	1 267 329	1 303 103	2 233 664	1 366 211	1 478 234	1 270 906	1 353 656	1 449 086
Të ardhura të B/sh të vërtetuara	137 305	149 749	169 421	207 769	242 944	280 238	294 304	335 355	394 682	361 771	402 007	457 437	461 692	508 977
SHPENZIME	475 456	475 456	558 228	570 598	681 852	758 367	4 285 238	1 376 498	1 260 846	864 288	799 332	1 552 142	1 504 289	1 496 932
Shpenzime jetese	375 456	375 456	438 228	438 228	492 354	546 480	546 480	546 480	546 480	564 096	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi				12 370	139 498	151 887	158 758	750 018	607 845	212 133	179 236	329 441	176 035	118 514
Pagesë tatimi për shijtjet e pasurive									6 521					
Pagesë regjistrimi pasurie										38 059	6 000			
Shpenzime mobilimi	100 000	100 000	100 000	100 000										
Shpenzime arsimimi të fëmijëve			20 000	20 000	50 000	60 000	80 000	80 000	100 000	50 000	50 000	342 709	431 150	438 050
Dhënë hua shtetasit I.B.							3 500 000							
Rezultati i analizës financiare	1 435 231	-393 543	245 901	-682 187	-146 001	-156 257	-107 911	-416 104	216 499	21 629	87 966	-453 377	-64 627	-1 020 627
CASH në lekë		800 000	1 100 000	1 400 000	1 600 000	1 300 000	100 000	500 000	500 000	500 000	500 000	500 000	500 000	450 000
DIFERENCA E PA MBULUAR	-3 440 634													

B. KONTROLLI I FIGURËS

219. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 2.11.20217, për subjektin, me të cilin ishte konstatuar papërshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Binas Nina.
220. DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit një raport vijues, me nr. *** prot., datë 11.2.2021, duke përfshirë edhe të dhëna dhe informacion shtesë – që referojnë për përfshirje të subjektit në korrupsion pasiv dhe në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqura edhe në formën e shpërdorimit të detyrës, në kohështirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit – në vijim të cilave Grupi i Punës së DSIK-së konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës të subjektit Binas Nina.
221. Raporti i lartpërmendur është deklasifikuar pjesërisht në datën 18.3.2021, me vendimin nr. *** , të KDZH-së.
222. Trupi gjykues, përgjatë hetimit administrativ, ka aksesuar, analizuar dhe vlerësuar disa materiale të klasifikuara, si dhe ka kërkuar e administruar disa dosje dhe akte profesionale që lidhen me *indiciet* e referuara në dokumentacionin e lartpërmendur.
223. Në vijim të hetimeve administrative, si dhe nga disa informacione të tjera nga organet ligjzbatuese, Komisioni, me qëllim verifikimin e tyre, iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2021, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021, vuri në dispozicion dosjet penale të kërkuara⁵⁸, nga shqyrtimi i të cilave ka rezultuar se:
224. **Dosja nr. 1** – dosja penale regjistruar me nr. *** , vitit 2017, ku subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar organin e akuzës dhe në përfundim të hetimeve ka marrë vendimin për pushimin e hetimeve për veprën penale “ndërtim të paligjshëm”⁵⁹, të parashikuar nga neni 199/a/1, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se vepra nuk parashikohet nga ligji, bazuar në pikën 2 të nenit 327 dhe germat “b” dhe “f” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.
225. Nga analizimi i dokumentacionit të disponuar duket se qëndrimi dhe konkludimi i subjektit të rivlerësimit në këtë rast duket kontradiktor me përmbajtjen e vetë akteve në dosjen hetimore përkatëse, duke u ngritur dyshime për favorizim të personave nën hetim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

226. Në prapësimet e dërguara, subjekti ka parashtruar se pushimi i hetimeve për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” është bërë me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se vendimi i marrë është i bazuar në ligj e në akte dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi penal dhe se vendimmarrjet nuk bien në kontradiktë me asnjë nga

⁵⁸Dosjen hetimore lidhur me procedimin penal të vitit 2008, me të hetuar shtetasin V.P., të mbrojtur nga shtetasi M.R.; dosjen hetimore me të pandehur shtetasin K.M.; dosjen hetimore me të pandehur shtetasin S.D.; dosjen hetimore me të pandehur shtetasin N. (D.) Ç.

⁵⁹Shtetasi E.D. kishte bërë një kërkesë në Bashkinë Gramsh për riparimin e murit ekzistues dhe për lëvizje dheu, që lidhen në mënyrë të posaçme me veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale. Bashkia Gramsh i ka kthyer përgjigje se për këtë lloj ndërtimi nuk kërkohet leje, fakt ky që konfirmohet edhe nga aktekspertimi në dosjen penale.

aktet hetimore, pjesë e fashikullit hetimor. Në këtë proces penal nuk ka pasur asnjë person, emri i të cilit është regjistruar si person nën hetim. Vendimi i pushimit i është njoftuar edhe kallëzuesit Hasan Latifi, i cili nuk e ka kundërshtuar këtë vendimmarrje.

227. Subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2017, nga ku konstatohet se Bashkia Gramsh, Sektori i Studimit dhe Projektimit Urban, ka autorizuar shtetasin E.D. për të paguar tarifën për lëshimin e dokumenteve për “ndërrhyrje që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi”, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2017, ku vërtetohet se këtij shtetasit i është lejuar të kryejë punime që nuk kërkojnë leje ndërtimi, akt ekspertize, si dhe një kërkesë të shtetasit për tërheqjen e dosjes penale.

Vlerësimi i trupit gjykues

228. Nga analizimi i dokumentit “vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penale nr. ***, të vitit 2017”, rezulton se nga hetimet e zhvilluara në datën 1.4.2017, në parcelën e shtetasit E.D. është konstatuar një mur rrethues me themel në ndërtim e sipër, me gjatësi 23.5 m dhe gjerësi 105 cm, çka të krijon bindjen se bëhet fjalë për një ndërtim në punë e sipër dhe, rrjedhimisht, ngrihen dyshime se vendimi për pushimin e hetimeve lidhur me këtë çështje penale mund të ketë favorizuar personin nën hetim, pasi nuk pasqyron plotësisht faktet e konstatuara dhe se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore ose vlerësimi dhe konkludimi i tij nuk përputhet me faktet.

229. **Dosja nr. 2** – materiali kallëzues nr. *** i vitit 2019, me të pandehur shtetasin D.Ç., përfaqësuar nga av. B.S., sipas aktit të përfaqësimit (pa datë) për veprën penale “prodhim e shitje të lëndëve narkotike”⁶⁰, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se subjekti ka ngritur akuzën për shtetasin D.Ç., për veprën penale “prodhim e shitje e lëndëve narkotike”, si dhe shtetasin B.P. për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, dhe për këtë të fundit është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit ndarja e procedimit penal nr. ***, duke formuar procedimin nr. ***, të vitit 2019. Në mbështetje të nenit 93 të Kodit Penal ai ka bërë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykatë, në ngarkim të dy të pandehurve, si më lartpërmendur. Është konstatuar se në diskutimin përfundimtar të depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në ngarkim të të pandehurit D.Ç., prokurori ka kërkuar: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit D.Ç., dënimin e tij me 5 vjet burg, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 3 vjet e 4 muaj burgim, si dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim, duke e vënë të pandehurin në provë për 4 vjet”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 20.11.2019, ka pranuar kërkesën prokurorit dhe ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit D.Ç., për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit D.Ç. me 3 vjet e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurin, për një periudhë kohe prej 4 vjet”*.

⁶⁰Shtetasit B.P., N.P., D.Ç. dhe L.Ç., të cilët janë ndaluar së bashku në automjetin nën drejtimin e shtetasit B.P. Gjatë ndalimit nga policia është konstatuar se shtetasit D.Ç. i janë gjetur substanca narkotike. Shtetasit kishin pohuar që kishin përdorur substanca narkotike, fakt ky që u provua edhe nga aktet e ekspertimit.

230. Nga analizimi i dokumentacionit dhe veprimeve hetimore të ndërmarra nga prokurori, duket se përveç veprave penale “prodhim e shitje e narkotikëve” dhe “drejtim të automjetit në mënyrë të parregullt”, procedimi penal nr. *** nga organi i akuzës nuk ka ndërmarrë veprime të tjera hetimore të mëtejshme të tjera, në ngarkim të personave të tjerë të përfshirë në ngjarje, të cilët, sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 14.10.2019, për shtetasin B.P. është zbuluar/evidentuar prania e produkteve kanabinodike të metabolizmit të bimës *cannabis sativa*, akti toksikologjik nr. ***, datë 14.1.2019, për shtetasin L.Ç., aktekspertimi nr. ***, datë 14.1.2019, për shtetasin N.P., të cilët, referuar procesverbaleve të mbajtura, kanë pohuar se janë përdorues të substancave narkotike në vendin ku jetojnë.
231. Nisur nga sa më lart, nuk janë të qarta rrethanat dhe ngrihen dyshime për veprimet hetimore të ndërmarra sa u takon personave të tjerë të përfshirë në ngjarjen e datës 2.1.2019, për të cilën janë akuzuar vetëm shtetasit D.Ç. dhe B.P. Mbeten të paqarta veprimet hetimore të ndërmarra nga organi i akuzës, duke krijuar kështu dyshime mbi favorizim për persona të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje – në këtë mënyrë është evituar aplikimi e rrethanës rënduese të kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, në grup me mbi tre persona, edhe për dy të dënuarit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

232. Në prapësimet e dërguara lidhur me këtë çështje, subjekti ka shpjeguar se *çështja penale është dërguar për gjykim me të pandehur vetëm shtetasin D.Ç., për veprën penale “prodhim e shitje të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe se për shtetasin B.P., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, nga hetimi i plotë mbi faktin nuk ka rezultuar me asnjë prove që shtetasit L.Ç. dhe Namik Plaka të kenë konsumuar elementet e ndonjë vepre penale. Fakti pse ata kanë rezultuar përdorues të lëndës narkotike, pa kryer asnjë veprim tjetër të provuar që i lidh me lëndën narkotike prej 7 gramë, që i është gjetur shtetasit D.Ç., nuk mund t’i ngarkonte me përgjegjësi penale. Që në aktet e para të policisë, edhe pse dy shtetasit e lartpërmendur kanë pohuar se janë përdorues të lëndës narkotike në vendin ku banojnë jashtë Shqipërisë, referuar nenit 283/1 të Kodit Penal, pasi ata nuk kanë krijuar dyshim, pasi nuk kishte prova që shtetasit e lartpërmendur e kanë lëndën narkotike të përbashkët.*
233. Ndërsa, lidhur me shtetasin B.P., për të cilin nuk ishte ngritur akuzë, subjekti ka shpjeguar se *megjithatë, lidhur me këtë çështje, jo vetëm që nuk ka favorizuar, por ka ngritur akuzë edhe për një shtetas tjetër B.P., për të cilin fillimisht nuk kishte referim për kryerje vepre penale. Për të provuar sa më lart, subjekti ka vënë në dispozicion diskutimin përfundimtar për dërgimin e çështjes penale me të pandehur shtetasin D.Ç., vendimin nr. ***, datë 20.11.2019, të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndërkohë, lidhur me shtetasin tjetër B.P., rezulton se prokurori Binas Nina ka depozituar në gjykatë kërkesën për deklarimin fajtor të shtetasit B.P., për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe dënimin e tij. Lidhur me konstatimin e Komisionit se në paragrafin e tretë të kërkesës së prokurorit nuk përcaktohen qartësisht parashikimet ligjore në nenin 59 për “pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim”, paragrafi i parë i Kodit Penal nuk është i saktë referuar përmbajtjes së këtij akti, ka shpjeguar se: “Në faqen 4 të këtij akti gjenden të shënuara tekstualisht rrethanat të cilat kanë çuar prokurorin në kërkimin e aplikimit të alternativës së dënimit, referuar nenit 59 të Kodit Penal, të tilla si, qëndrimi pendues, gjendja ekonomiko-sociale, vlerësimi moralo-shoqëror,*

mosqenia i dënuar më parë, probleme mjekësore etj., sasia e vogël e sekuestruar në kufijtë e përdorimit vetjak. Dhe se për këtë çështje nuk rezulton asnjë lloj favorizimi”.

Vlerësimi i trupit gjykues

234. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni arrin në përfundimin se mbeten të paqarta shkaqet e mungesës së veprimeve hetimore nga subjekti në ngarkim të dy shtetasve të tjerë (të cilët sipas aktekspertimit ishin përdorues të lëndëve narkotike), duke mos ndryshuar apo shteruar dyshimet e ngritura në rezultatet e hetimit administrative lidhur me këtë çështje.
235. **Dosja penale nr. 3** – procedimi penal ndaj personit nën hetim, shtetasit K.M., të akuzuar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Prokurori ka depozituar kërkesën për vleftësimin e masës së arrestit brenda afatit 48 orë, duke kërkuar lënie në fuqi të masës së sigurimit “të paraqitjes” të shtetasit pranë policisë gjyqësore. Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 3.8.2006, sipas dokumentit “shkurtim vendimi”, ka vendosur: *“Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj shtetasi K.M., caktimin e masës së sigurimit ndaj të arrestuarit, atë të detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore”*. Vendimi i sipërcituar nuk është ankimuar nga pala e dëmtuar, pasi në dosjen penale rezulton të jetë një deklaratë noteriale e bashkëshortit të të dëmtuarës⁶¹.
236. Konstatohet se, në vijim të analizimit të dokumentacionit të sipërcituar, kanë rezultuar dyshime mbi bazueshmërinë e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimit të çështjes në fjalë, nga momenti që ky hetim kishte për objekt veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit”, pasi edhe nga ekspertiza e kryer (provë e administruar në fashikullin gjyqësor) ka rezultuar se i dyshuari, në momentin që ka ndodhur aksidenti automobilistik, ka drejtuar automjetin e tij me shpejtësi shumë më të madhe se ajo e lejuar, duke humbur kontrollin e drejtimit të automjetit, me pasoja tepër të rënda – në shkelje të qartë të Kodin Rrugor, specifikisht të pikave 1 dhe 2 të nenit 139. Pra, minimalisht në këtë rrethanë ka pasur një shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, të konkretizuar pikërisht në mosrespektimin e shpejtësisë maksimale të parashikuar nga dispozitat ligjore, pavarësisht peshës specifike që ky fakt mund të ketë pasur (ose jo) në shkaktimin e aksidentit të ndodhur, objekt hetimi.
237. Këto rrethana duket se ngrenë dyshime mbi konkluzionet e subjektit dhe mbi veprimet hetimore jo të plota dhe jo të mirargumentuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat, në mënyrën se si janë administruar e zhvilluar, mund të kenë favorizuar personin e dyshuar, duke vendosur më pas pushimin e hetimeve në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁶¹Ndërkohë, rezultojnë se në urdhrin e prokurorit Binas Nina “për ekzekutimin e vendimit penal”, dokumenti nr. ***, i datës 3.8.2006, është shprehur jo saktësisht, sikurse ka disponuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili citon shprehimisht: *“Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe lënie e tij në fuqi. Të caktojë si masë sigurimi për K.M., atë të ndalimit të daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale”,* ndërkohë, në urdhrin e prokurorit citohet: *“Ekzekutimin e vendimit penal nr. ***, datë 3.8.2006, të Gjykatës së Elbasanit dhe lirimin e menjëhershëm të të arrestuarit Klodjan Muçina, nëse nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër”*. Gjithashtu, prokurori, me vendimin e datës 15.8.2006, ka vendosur “pushimin e çështjes, me argumentimin se fakti nuk parashikohet nga ligji, bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale”.

238. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë çështje, ka prapësuar se: “[...] është tërësisht në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 290 të Kodit Penal, pasi neni 290 i Kodit Penal kërkon si rrethanë cilësuese ardhjen e pasojës së rëndë për të pasur vepër penale, përndryshe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor ngelet kundërvajtje administrative, sado e rëndë qoftë shkelja rrugore nga drejtuesi i mjetit. Në dosje ka një konkluzion akti mjeko-ligjor mbi humbjen e shkallës së aftësisë për punë, i hartuar nga eksperti i fushës. Në asnjë rast ky konkluzion shkencor nuk është vënë në diskutim. Oficeri i policisë gjyqësore, pasi ka kryer hetimet, ka rekomanduar pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se pasoja është e lehtë dhe nuk kemi vepër penale, nuk ka asnjë lloj favorizimi, por një vendimmarrje të drejtë të bazuar në ligj. Nuk ka pasur asnjë indicie për të vënë në diskutim konkluzionin e ekspertimit mjeko-ligjor”. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka depozituar aktin mjeko-ligjor nr. ***, datë 4.8.2006, relacionin për përfundimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2006, nga OPGJ-ja, si dhe vendimin për pushimin e çështjes për procedimin penal nr. ***, të vitit 2006.

Vlerësimi i trupit gjykues

239. Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues – pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe argumentimet e subjektit, si dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur prej tij së bashku me prapësimet, nga një analizë e përmbajtjes së tyre në raport me parashikimet e dispozitave ligjore përkatëse (veçanërisht neni 290 i Kodit Penal) – mbërrin në konkluzionin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se nuk janë konstatuar veprime favorizuese apo shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

240. **Dosja penale nr. 4**, me të pandehur shtetasit V.P., E.P. dhe A.(A.) K., akuzuar për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga nenet 131/2 dhe 25 të Kodit Penal. Fillimisht, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore dhe brenda afateve procedurale, ka paraqitur kërkesën me objekt “vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit V.P. dhe shtetasit e tjerë”⁶², kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 12.4.2008.

241. Më tej, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan është depozituar një kërkesë nga av. M.R., për revokimin dhe zëvendësimin e masës së sigurimit për të pandehurin V.P., por kjo kërkesë ka qenë jo në formën e kërkuar nga ligji, konkretisht nga neni 111 i Kodit të Procedurës Penale⁶³, pasi i arrestuari Veteran Pinderi nuk e kishte nënshkruar kërkesën dhe se ajo nuk ishte vërtetuar nga institucionet e paraburgimit ku ai vuante dënimin; kjo deklaratë e thjeshtë për përfaqësimin e të pandehurit ishte nënshkruar nga vëllai i shtetasit B.P. dhe pa praninë e personit të paraburgosur, vërtetuar kjo nga institucioni i paraburgimit ku ai ndodhej⁶⁴. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 2.5.2008 dhe me shkresën nr. ***, datë 5.5.2008 vendimi iu dërgua organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. ***, datë 21.4.2008 është vendosur mosshqyrtimi i kësaj kërkesë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 12.4.2008, i cili ka marrë formë të prerë

⁶²Për shtetasit A. K. dhe E. P. masa e sigurimit është dhënë nga gjykata, “detyrim paraqitjeje”.

⁶³Neni 111 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “I pandehuri i izoluar me masë sigurimi ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklarata nëpërmjet drejtorit të institucionit, i cili lëshon dokument për marrjen në dorëzim të tyre. Ato regjistrohen në një libër të veçantë, i komunikohen menjëherë organit kompetent dhe kanë efekt njëlloj sikur të ishin pranuar drejtpërdrejt nga ai organ”.

⁶⁴Në dosjen e përcjellë rezulton të jetë dokumenti prokurë e posaçme nr. ***, datë 15.5.2008, nga bashkëshortja e shtetasit V.P. Hartimi kësaj prokurë është bazuar në pikën 3, të nenit 48, të Kodit të Procedurës Penale.

në datën 22.4.2008, ka vendosur: *“Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e arrestit me burg ndaj shtetasit Veteran Pinderi, duke urdhëruar mbajtjen në institucion paraburgimi”*, duke konfirmuar kështu edhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit⁶⁵.

242.Fillimisht, subjekti i rivlerësimit ka ngritur akuzën, referuar nenit 134/2 të Kodit Penal⁶⁶, për veprën penale “vjedhje e kryer në bashkëpunim” nga të tre shtetasit, të cilët, në koordinim me njëri-tjetrin, kanë pasur qëllim dhe kanë realizuar marrjen e gjësë së gjallë, pasuri e cila nuk ishte e tyre, duke kryer në mënyrë të fshehtë e të kundërligjshme veprimin e therjes së gjësë së gjallë, veprime për të cilët gjykata ka marrë vendimet nr. *** dhe nr. ***, datë 12.4.2008, për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës “detyrim paraqitjeje”, vendim të cilat kanë marrë formë të prerë.

243.Më tej, në kërkesën e tij të depozituar në gjykatë, subjekti ka kërkuar gjykimin për procedimin penal nr. ***, të vitit 2008, vetëm për shtetasin V.P., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal⁶⁷, me argumentin se ky shtetas ka pohuar dhe ka pranuar anën objektive të kryerjes së veprës penale, duke konsumuar të gjitha elementet e veprës penale, pasi ka vënë dorë mbi pasurinë e tjetrit, veprime këto të parashikuara nga neni 134/1 i Kodit Penal.

244.Në diskutimin përfundimtar të depozituar nga prokurori në gjykatë është kërkuar: *“Deklarimi fajtor i shtetasit Veteran Pinderi për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimi i tij në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me kohën e paraburgimit”*. Nga shënimi në këtë dokument, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e datës 25.6.2008, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të shtetasit V.P. për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 5 muaj e 10 ditë burgim”*.

245.Nga vlerësimi i dokumentacionit në dosje, nuk rezulton që gjatë veprimeve hetimore të kryera të jetë konstatuar nga prokuroria ndonjë fakt apo rrethanë e ndryshme apo e re nga ç’është përshkruar fillimisht në kërkesën për gjykim të kërkuar nga prokurori⁶⁸. Ndonëse fillimisht akuza është ngritur për veprën penale të parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal, e më tej, më pas – pa shkak të arsyeshem apo pa sjellë ndonjë rrethanë të re të ndryshuar – ajo është paraqitur për gjykim për veprën penale të parashikuar në nenin 134/1 të Kodit Penal, në të cilin përcaktohet një masë dënimi më e lehtë. Kjo dinamikë ngre dyshime për favorizim, sa i takon masës së dënimit të kërkuar ndaj të pandehurve, të përfshirë në këtë ngjarje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

246.Subjekti ka depozituar aktin mjeko-ligjor nr. ***, datë 4.8.2006, relacionin për përfundimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2006 nga OPGJ-ja, si dhe vendimin për pushimin e çështjes

⁶⁵Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion duket se fillimisht subjekti i rivlerësimit ka ngritur akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, duke caktuar ndaj tyre edhe masën e sigurimit, kërkesa të cilat janë vleftësuar si të ligjshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimet nr. ***,*** dhe ***, datë 12.4.2008.

⁶⁶Neni 134/2 i Kodit Penal parashikon: *“Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”*.

⁶⁷Neni 134/1 i Kodit Penal parashikon: *“Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”*.

⁶⁸Në kërkesën e tij, prokurori i ka kërkuar gjykatës të marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanat lehtësuese, vlerën e vogël të dëmit të shkaktuar, normalizimin e marrëdhënieve, si dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit.

për procedimin penal nr. ***, të vitit 2006. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara, ka sqaruar se: “[...] me cilësinë e prokurorit të çështjes, duke iu referuar vlerës provuese të akteve të grumbulluara deri në atë fazë të hetimit që në momentin e caktimit të masave të sigurimit, duke qenë se aktet që gjendeshin në dosje nuk provonin përfshirjen e dy shtetasve të tjerë në vjedhje, për të cilët është pushuar çështja, është kërkuar masë sigurimi detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Hetimi nuk ka provuar kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, në këtë mënyrë nuk ka pasur asnjë favorizim për personat nën hetim. Kualifikimi i veprës penale nga ana e prokurorit ka qenë i drejtë, pasi gjykata ka gjetur fajtor shtetasin. Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në përfundim të tij rrethanat nuk kanë ndryshuar, duke qenë se nuk u provua ndryshe, nuk mund të akuzojoja dy persona pa prova. Dosja është paraqitur për gjykim për veprën penale të parashikuar në nenin 134/1 të Kodit Penal, pasi provat e grumbulluara kanë provuar konsumimin e veprës penale vetëm nga V.P.”. Bashkëlidhur prapësimeve është paraqitur urdhri i regjistrimit të veprës penale nga Drejtuesi i Prokurorisë. Ndërsa në seancën dëgjimore, subjekti ka paraqitur një dokument të ri të titulluar “procesverbal për marrjen e të dhënave nga persona që kanë dijeni nga shtetasit F.M.”.

247. Në datën 2.12.2021 subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, ka dërguar vendimin nr. ***, datë 11.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin M.R., të akuzuar për veprën penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, për të cilin vendimi ka marrë formë të prerë në datën 21.6.2017, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila e ka deklaruar fajtor, duke e gjobitur me gjobë dhe ndalim të ushtrimit të të drejtës së profesionit.

248. Nga shqyrtimi i vendimit të lartpërmendur konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurori që ka kërkuar në datën 12.4.2008 në gjykatë masën e sigurimit “arrest me burg” për shtetasin V.P., kërkesë e pranuar, dhe ky i fundit ka qenë i përfaqësuar në seancë gjyqësore nga avokati M.R., i cili nuk ka qenë i pajisur sipas kërkesave të ligjit me prokurë nga i pandehuri V.P., duke u bërë shkak për mospranimin e kërkesës së tij për ndryshimin e masës “arrest me burg”. Me tej, për këtë shtetas M.R. është ngritur një kallëzim, objekt i vendimit, pasi është akuzuar nga familjarët e shtetasit V.P. se ka kërkuar ryshfet si për prokurorin (subjektin e rivlerësimit), edhe për gjykatësin, për të cilin gjykata ka vendosur më tej deklarimin fajtor dhe gjobitjen e tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

249. Nga tërësia e rrethanave, si dhe nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion edhe në seancën dëgjimore nga subjekti, Komisioni arrin në përfundimin se shpjegimet e subjektit janë deri diku bindëse lidhur me evoluimin e njohjes së rrethanave nga momenti i regjistrimit të veprës penale – për më tepër të bërë nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe jo nga subjekti – e deri në mbylljen e hetimit. Për rrjedhojë, përpos dyshimeve të ngritura edhe nga informacionet e klasifikuara, përfundimisht trupi gjykues çmon se në këtë çështje nuk u evidentua ndonjë shkelje konkrete apo ndonjë veprim specifik favorizues nga subjekti, që mund të ketë passjellë favorizimin e personave të tjerë të dyshuar.

250. Trupi gjykues, pasi ka analizuar konkluzionet dhe informacionet e përcjella nga DSIK-ja dhe ka shqyrtuar përmbajtjen e dokumenteve të klasifikuara dhe konstatimet e organeve ligjzbatuese, duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin e subjektit, çmon se nuk kanë

rezultuar prova të qarta lidhur me kontakte të papërshtatshme të subjektit, rrethanë kjo që e bën të pamundur aplikimin e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 86/2016. Megjithatë, parë në tërësi dhe në kombinim midis tyre të: (i) *indicieve* dhe informacioneve të klasifikuara, të cilat, vetëm për sa i përket dosjeve nr.*** dhe ***, në njëfarë mënyre mund të konsiderohen të konfirmuara nga: (ii) dinamika dhe konkludimi i çështjeve përkatëse; (iii) qëndrimet, veprimet hetimore dhe konkluzionet e subjektit në dosjet profesionale të shqyrtuara pikërisht në funksion të *indicieve* të konstatuara mbi figurën; dhe (iv) shpjegimeve të subjektit lidhur me disa çështje jo bindëse – trupi gjykues çmon se këto rrethana përbëjnë elemente që kontribuojnë në konkluzionin e cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe që kësaj duhet të mbahen në vëmendje në aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në gërshetim me konstatimet e tjera, të cituara më herët, që passjellin efekte dhe pasoja të këtij lloji dhe që lidhen edhe me kriterin e pasurisë dhe të aftësive profesionale.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Vlerësimi i aftësive profesionale nga KLP-ja

- 251.Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar raportin e KLP-së për analizimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin e cituar, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Binas Nina. Në të janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si vijon: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore.
- 252.Saktësia e formularit të vetëdeklarimit – formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 253.Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit – duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Binas Nina, për periudhën shtator 1995 dhe deri aktualisht, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- 254.Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore – subjekti i rivlerësimit Binas Nina ka deklaruar se gjatë 3 viteve të fundit ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në fushën e së drejtës penale materiale dhe procedurale.
- 255.Për sa iu përket të dhënave statistikore – prokurori Binas Nina ka deklaruar se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të ushtrimit të detyrës i janë caktuar gjithsej 517 çështje penale, si dhe

1351 vendime penale të formës së prerë për të kryer procedurat e ekzekutimit. Prokurori ka përfunduar gjatë 3 viteve të fundit të ushtrimit të detyrës gjithsej 498 çështje penale dhe ka kryer procedurat për ekzekutimin e 1351 vendimeve të formës së prerë. Prokurori Binas Nina, në ushtrimin e detyrës, ka mbartur për vitin 2017 gjithsej 18 çështje penale.

256. Trajnimet në 3 vitet e fundit – prokurori Binas Nina ka deklaruar trajnime të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës brenda periudhës së rivlerësimit, duke i bashkëlidhur formularit edhe dokumentin vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës.

257. Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit – gjatë periudhës së vlerësimit, prokurori Binas Nina ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore, 2 dokumente të llojit “vendim” dhe 1 dokument të llojit “diskutim përfundimtar”. Konkretisht, janë paraqitur dokumentet ligjore: vendim pushimi për procedimin penal nr. ***, të vitit 2015; kërkesë për gjykim për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016; si dhe diskutim përfundimtar për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurit M.M. Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, konstatohen këto gjetje:

258. **Dokumenti nr. 1** – vendim “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2015”, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit Binas Nina, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në mbështetje të pikës 2 të nenit 327 dhe germës “b”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, në datën 17.10.2016, ka vendosur: “*Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, në ngarkim të personit nën hetim A.Z. Heqjen e masës së sigurimit, atë të detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, vendosur me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*⁶⁹”.

259. **Dokumenti nr. 2** – “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016”. Në datën 2.12.2016 subjekti i rivlerësimit Binas Nina, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, mbi bazën e materialit hetimor të referuar nga Komisariati i Policisë Elbasan⁷⁰. Pas administrimit të akteve të ekspertimit subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar të përfunduar hetimin paraprak dhe ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurit K.Z., për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal.

260. **Dokumenti nr. 3** – diskutim përfundimtar “Për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga aktet e administruara Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim

⁶⁹Në datën 5.8.2015, rreth orës 20:45, në lagjen “****”, në ambientet e stadiumit “****”, policia ka qenë e planëzuar me shërbim në hyrjen “E” të këtij stadiumi, ku zhvillohej ndeshja S***– M***. Në momentin e hyrjes, në ambientet e stadiumit, gjatë kontrollit fizik të shtetasit A.Z., në brendësi të paketës së cigareve që kishte ky shtetas, janë gjetur dy cigare të dredhura. Brenda këtyre cigareve kishte material bimor të lëndës narkotike të llojit *cannabis- sativa*. I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi A.Z. ka pohuar se cigaret që i janë gjetur kanë material bimor të lëndës narkotike të llojit hashash, të cilat i ka për përdorim vetjak. Cigaret i ka blerë në vlerën 1.000 lekë te një person që nuk ia di emrin.

⁷⁰Në datën 17.8.2016, rreth orës 18:00, në unazën jugore tek “Kryqëzimi i Kinezëve”, Elbasan, shtetasi K.Z., i pajisur me leje drejtimi të kategorisë “D”, duke drejtuar automjetin tip “Benz” me targa ***, taksi, me drejtim lëvizjeje në unazën e qytetit, i ka ndërprerë rrugën motoçikletës pa targa, që drejtohej nga shtetasi S.M. dhe si pasojë e kësaj përplasjeje është aksidentuar ky shtetas.

të pandehurit M.M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkeljes e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal⁷¹. Komisioni konstaton se dokumenti ligjor “diskutim përfundimtar”, rezultoi i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese, duke u mbyllur me kërkimet konkrete drejtuar gjykatës.

261. Nga shorti i hedhur, rezultoi se u përzgjedhën në mënyrë rastësore një vendim mosfillimi, dy vendime pushimi dhe dy vendime për dërgimin e çështjes për gjykim. Gjetjet nga vëzhgimi/shqyrtimi i këtyre pesë dosjeve përshkruhen, si më poshtë vijon:

262. **Dosja nr. 1** – kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 5.8.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dokumenti ligjor, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 1.9.2016, për kallëzimin penal nr. ***, datë 11.9.2016, për veprën penale “rrahje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal⁷². Në mbështetje të germës “e”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 1.9.2016, prokurori Binas Nina ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 5.8.2016. Të njohë me këtë vendim kallëzuesit dhe me të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, brenda pesë ditëve nga marrja dijani për këtë vendim”*.

263. **Dosja nr. 2** – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 9.9.2015, për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dokumenti ligjor që i përket vendimit “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”, datë 24.11.2015, hartuar nga prokurori Binas Nina, subjekti rivlerësimi⁷³. Nga hetimet paraprake nuk ka rezultuar që vetëhelmimi i shtetasit Sh.Ç. të jetë si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik, kështu, bashkë me informacionin për referimin e veprës penale, datë 7.8.2015, policia gjyqësore ka përcjellë pranë prokurorisë edhe disa materiale⁷⁴. Rezultoi se me urdhrin “Për delegimin e veprimeve hetimore”, datë 9.9.2015, prokurori ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore që të kryejë disa veprime hetimore me afat të përcaktuar deri në datën 30.10.2015. Prokurori, në datën 9.9.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shkaktim të vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.

264. **Dosja nr. 3** – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 16.12.2013, për kryerjen e veprës penale “përkrahje të autorit të krimit”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 302/1 dhe 25 të Kodit Penal. Vendim “Për pushimin e çështjes penale”, datë 27.7.2014, përgatitur nga

⁷¹Në datën 29.7.2016, ora 18:50, në aksin rrugor Librazhd - Elbasan, dhe pikërisht në vendin e quajtur “****”, shtetasi M.M., i pajisur me leje drejtimi të kategorisë “B”, duke drejtuar automjetin tip “Ford Focus”, me targa ***, nën ndikimin e alkoolit në masën 0/35 mg/litër, ka përplasur biçikletën të drejtuar nga shtetasi K.S., i cili, si pasojë e këtij aksidenti, është transportuar në spital në gjendje të rëndë.

⁷²Në datën 2.8.2016 ka bërë ankim shtetasja M.Gj., e cila, në ankimin e saj ka deklaruar se në datën 2.8.2016, rreth orës 13:30 ka shkuar tek zyrat e katit të parë të shoqërisë “****”, rruga “****”, lagja nr. ***, Librazhd, pronë për të cilën pretendon se e ka të vetën. Pas një konflikti me rojën e këtij objekti, shtetasin A.L., ky i fundit e ka kapur prej krahu me forcë dhe e ka goditur me shkelm në anën e majtë të mesit. Ankuesja M.Gj. ka kërkuar ndjekje penale ndaj shtetasit A.L.

⁷³Salla Operative e Drejtorisë së Policisë Elbasan është njoftuar se në spitalin e Elbasanit familjarët kanë sjellë të vetëhelmuar dhe në gjendje të rëndë shtetasin Sh.M.Ç., i datëlindjes 22.6.1940, banues në fshatin Gj*** të Elbasanit, i cili ka ndërruar në spital. Nga këqyrja e kufomës nuk u vërejtën plagë apo dëmtime të tjera fizike në trupin e tij. Sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 6.8.2015, ka rezultuar se shkaku i vdekjes së shtetasit Sh.Ç. është arresti kardio-respirator dhe se te kufoma konstatohet prania e lëndëve helmuese fotoksinë.

⁷⁴Informacion për referimin e veprës penale nga oficeri i policisë gjyqësore; procesverbal i këqyrjes së kufomës, datë 6.9.2015, shoqëruar me tabelën fotografike; procesverbal datë 5.9.2015, i pyetjes së shtetasit S.Ç.; procesverbal datë 9.11.2015, i pyetjes së shtetasit N.Ç.; si dhe vendim datë 6.8.2015, për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, datë 1.10.2015.

prokurori Binas Nina, subjekt rivlerësimi⁷⁵. Prokurori Binas Nina, në datën 16.12.2013 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “përkrahje të autorit të krimit”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 302/1 dhe 25 të Kodit Penal dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, shtetasve K.H. dhe A.A. Konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. *** (***), datë 17.12.2013, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së prokurorit për vleftësimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ për dy të arrestuarit”, me argumentimin se: “... organi i akuzës nuk paraqiti asnjë provë në të cilën bazohet kërkesa, dyshimi i arsyeshëm duhet të jetë i bazuar në prova dhe jo i supozuar, si dhe nga aktet e vëna në dispozicion nuk provohet që personit nën hetim të këtë konsumuar elemente të veprës penale për të cilën akuzohet, pasi asnjë provë nuk e implikon atë”.*

265.Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 10.4.2015, me të pandehur D.P., i akuzuar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 9.6.2015. Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015”, datë 9.6.2015, përgatitur nga prokurori Binas Nina, subjekt rivlerësimi⁷⁶. Komisioni ka konstatuar se hetimi i çështjes është kryer brenda afatit 3-mujor. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në ngarkim të të pandehurit D.P., në datën 20.7.2015 subjekti i rivlerësimit Binas Nina ka paraqitur konkluzionet përfundimtare dhe ka kërkuar: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit D.P., për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje’ dhe në bazë të nenit 134/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim”.*

266.Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 5.8.2014, me të pandehur N.K., akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, kryer dy herë, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 11.12.2014. Kërkesë “Për gjykimin e çështjes”, datë 11.12.2014, përgatitur nga prokurori Binas Nina, subjekt rivlerësimi⁷⁷. Prokurori i ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje Binas Nina, në datën 5.8.2015, bazuar në nenet 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “dhunë në familje”, kryer dy herë, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal dhe emrin e shtetasit N.K.

⁷⁵Në datën 13.12.2013, ora 20:30, shërbimet e policisë së Komisarariatit të Policisë Elbasan, pasi kanë marrë informacion se nga Librazhdi për në Elbasan po udhëtonte një person i kërkuar nga policia, shtetasi E.F., në automjetin me targa ***, në vendin e quajtur “****”, në lagjen “****”, Elbasan, shërbimet e policisë kanë ndaluar automjetin me targa ***, i cili drejtohej nga shtetasi A.A. dhe e kanë shoqëruar në Komisariatin e Policisë Elbasan. Në këtë automjet kanë qenë duke udhëtuar shtetasit E.F., person në kërkim, dhe shtetasi K.H.

⁷⁶Në datën 9.4.2015, rreth orës 11:00, shtetasja E.I.H., banuese në fshatin K***, komuna P***, Gramsh, ka njoftuar se gjatë natës së mëbrëmshme i është vjedhur lokalit bar-kafe dhe dyqan ushqimor pranë banesës së saj, ku i është vjedhur një shumë rreth 32.000 lekë.

Nga pyetja e shtetasit D.P., në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, rezultojnë se ai e pranon faktin që ka vjedhur lokalit e shtetasit E.I.H. Ai shpjegon se ka hyrë nga dritarja në krahun e sipërm të lokalit dhe pasi është futur në lokal ka marrë poshtë banakat çantën e parave dhe lekët e vjedhura i ka fshehur poshtë një pllake guri, te kasollja para shtëpisë. Në mëngjes ai ka numëruar paratë dhe ka konstatuar se kanë qenë gjithsej 2.600 lekë të reja.

⁷⁷Në datën 2.7.2014 është paraqitur në policinë gjyqësore shtetasja L.B., e cila ka bërë kallëzim për faktin se është me banim në fshatin M***, komuna Sh***, Elbasan. Në datën 2.7.2014 ajo, së bashku me bashkëshortin e saj, P.B., kanë prerë dru në tokën e tyre dhe për t’i çuar në shtëpi kanë marrë karrocierin Rr.T. Rreth orës 20:30, kur karrocieri Rr.T. ka kaluar para shtëpisë së shtetasit N.K., ky i fundit i ka thënë karrocierit që *drutë që ke ngarkuar shkarko tek shtëpia e saj*, por karrocieri i është përgjigjur se *drutë i ka ngarkuar për shtetasin P.B.* Aty janë afruar shtetasit L. dhe P.B. dhe N.K. ka goditur me grusht shtetasin P.B. Shtetasja L.B. është futur për t’i ndarë dhe N. K. e ka goditur me grusht dhe e ka kapur për fyti, duke e rrëzuar përtokë. Shtetasin P.B. e ka goditur me shkelma edhe djali i N., shtetasi D.K.

Procesverbal i ankimit, datë 2.7.2014, i shtetasit L.B.; procesverbal i ankimit, datë 2.7.2014, i shtetasit P.B.; akteksptimi mjeko-ligjor nr. ***, datë 3.7.2014; akteksptimi mjeko-ligjor nr. ***, datë 3.7.2014; procesverbalet datë 2.7.2014, e pyetjes së shtetasve L. e P.B., dhe D. e Dh.K.

si person nën hetim. Në datën 11.12.2014 prokurori Binas Nina ka formuluar me shkrim aktin procedural “Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për shtetasin N.K., në mungesë, përfaqësuar nga avokati A.K. Me këtë vendim shtetasi N.K. është marrë i pandehur për veprën penale “dhunë në familje”, kryer dy herë, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit N.K., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje”, kryer dy herë, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal. Sa i takon shtetasit D.K., subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për gjykim, ka argumentuar se: “... ai ka goditur me shkelm shtetasin P.B., duke konsumuar elementët e veprës penale ‘rrahje’, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal dhe bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari akuzues ka të drejtën e ankimit në gjykatë”. Nisur nga praktikat e ndjekura në prokurori, ky argumentim që ka bërë subjekti i rivlerësimit për pozicionin procedural të shtetasit D.K., nuk është i saktë. Në rrethanat e ngjarjes vlerësohet që shtetasi D.K. është bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale “dhunë në familje” dhe duhet të ishte akuzuar edhe ai për këtë veprë penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

267. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Përgjegjësia penale është personale, në rastin konkret shtetasi N.K., sipas nenit 130/a të Kodit Penal ishte subjekt me cilësi të veçanta, pasi bënte pjesë në rrethin e personave që sipas nenit 130/a të Kodit Penal hyjnë në kategorinë e familjarëve, ndërsa D.K. nuk bënte pjesë në rrethin e personave që sipas nenit 130/a konsumojnë dhunë në familje (ai është nipi i L.B.). Vendimi është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan që e ka lënë në fuqi kualifikimin ligjor. Në rastin konkret, prokurori ka kërkuar 6 muaj burgim. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim. Mos ushtrimi i ankimit nuk bie ndesh me udhëzimin nr. ***, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ai udhëzim nuk orientonte ankim për situata të kësaj natyre”.
268. Nga sa më sipër është përshkruar, lidhur me përjashtimin e shtetasit D.K. nga kategorizimi që i bën neni 130/a i Kodit Penal, ku në nenin 130/a, përcaktohet se: “Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort [...] gjini e afërt ose [...] me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet”. Subjekti ka depozituar informacion mbi referimin e veprës penale për shtetasit M.B. dhe D.B., nga shqyrtimi i të cilës konstatohet se nuk ndryshon rezultati i arritur.
269. Komisioni arrin në përfundimin se, për sa kohë nuk është depozituar ndonjë dokumentacion për të provuar të kundërtën, konkluzioni i arritur nuk ndryshon, për aq kohë sa shtetasi D.K. klasifikohet nisur edhe nga praktika e deritanishme, si “gjini e afërt”, referuar nenit 130/a të Kodit Penal.
270. **Dokumenti ligjor nr. 5** – “kërkesë” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale. Në pjesën hyrëse, prokurori Binas Nina përshkruan subjektin që parashtrohet kërkesën, emërtimin e dokumentit, subjektin që i drejtohet kërkesa, si dhe të dhënat e procedimit penal në kuadër të të cilit përgatitet akti ligjor.

C/2. Të dhëna nga burime arkivore

- 271.Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton, si më poshtë vijon:
- 272.Me urdhrin nr. ***, datë 13.1.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm është pezulluar nga detyra subjekti i rivlerësimit Binas Nina, bazuar në informacionin e përpiluar për procedimin penal nr. ***, të vitit 2005, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Prokurori ka pasur në hetim këtë procedim, në ngarkim të të pandehurve D.C. dhe G.S., regjistruar për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.
- 273.Nga kontrolli i ushtruar në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Elbasan, punonjësit e policisë i kanë gjetur të pandehurit F.I. disa letra që shërbenin si korrespondencë ndërmjet të arrestuarit D.C. dhe nënës së tij, shtetases Sh.C. Në një nga këto letra kjo shtetase i ka shkruar të pandehurit se: *“Prokurorin e paguan sa i kërkoi vetë dhe më solli haber që në goftë se e kam ndihmuar 50% tani 100%”*.
- 274.Pas verifikimit të çështjes, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. ***, datë 8.2.2006, ka vendosur: *“Ndërprerjen e pezullimit të prokurorit Binas Nina dhe rifillimin në detyrën e mëparshme”*. Nga shqyrtimi dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se: *“Gjatë fazës së hetimeve paraprake shtetasja Sh.A., nëna e të arrestuarit, ka deklaruar se ajo për këtë çështje ka paguar vetëm avokatin e djalit të saj dhe se nuk i ka dhënë askujt tjetër lekë, në lidhje me faktin se ajo është shprehur se i ka dhënë lekë edhe prokurorit në letrën e kapur në burg djalit të saj, ajo ka shpjeguar se ka ikur në vitet 1991 në Greqi dhe se nuk bën dot dallimin midis prokurorit dhe avokatit. E për këto arsye, me urdhrin e sipërcituar, është ndërprerë pezullimi i subjektit të rivlerësimit Binas Nina dhe rifillimi në detyrën e mëparshme”*. Nuk ka pasur masa disiplinore.
- 275.Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime, në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta. Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para.
- 276.Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2020, bën me dije se nga verifikimi i praktikave të trajtuara rezulton se për subjektin e rivlerësimit Binas Nina ka dy ankesa.
- 277.Praktika nr. *** prot., datë 20.11.2014, ka të bëjë me ankesën e shtetasit S.D., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Ankuesi S.D., në letrën e tij, ka shpjeguar se dy prokurorët e Elbasanit, E.Gj. dhe Binas Nina, kanë mbrojtur përmbaruesin K.K., për arsye se ka bashkëshorten kancelare në prokurori. Përmbaruesi mashtroi dhe i mori shtëpinë dhëndrit dhe vajzës së ankuesit, shtetasve B. dhe D. B., me dokumente false dhe i largoi me një vendim gjykate që nuk mban emrin e B.
- 278.Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Shqipërisë. Me shkresën nr. *** prot., datë 7.1.2015, ankuesit S.D. i është kthyer përgjigje se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan,

në datën 11.10.2011 është paraqitur kallëzim nga shtetasi B.B., i cili ka shpjeguar se kishte blerë një apartament në vitin 2000 në qytetin e Peqinit dhe në vitin 2007 shtetasi I.M., për shkak të lidhjeve miqësore, i ka kërkuar që të vinte si garanci bankare banesën për shkak të marrjes së një kredie në fondacionin “****”, Peqin. Shtetasi B.B. ka pranuar dhe është përpiluar akti përkatës te noteri. Meqenëse një vit pas marrjes së kredisë shtetasi I.M. ka ndërprerë pagesën e kredisë dhe është larguar pa adresë, kanë filluar procedurat e ekzekutimit të garancisë pasurore të shtetasit B.B., sipas përmbajtjes së kontratës së nënshkruar vullnetarisht nga i ndjeri B.B. Duke qenë se marrëdhëniet mes palëve janë juridiko-civile dhe duhet t’i drejtohen gjykatës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin datë 2.11.2011, ka vendosur mosfillimin e hetimeve për kallëzimin e shtetasit B.Basha.

279.Praktika nr. *** prot., datë 17.10.2011, ka të bëjë me ankesën e shtetasit R.Sh., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Ankuesi R.Sh., në letrën e tij, ka shpjeguar se prokurori Binas Nina ka hetuar ngjarjen e nënës së tij, shtetases E.Sh., e cila është përdhunuar forcërisht në mbrëmjen e datës 12.9.2010, në moshën 84 vjeç. Ky fakt tani është provuar plotësisht. Nëna e tij e vuri gishtin mbi një person dhe denoncoi shtetasin K.Sh., fqinj me nënën e tij, i cili u arrestua, por sot gëzon liri. Prokuror Binas Nina qëllimisht ka zvarritur hetimet për mos zbardhjen e ngjarjes. Për këtë arsye, ankuesi kërkon inspektimin e dosjes hetimore të hetuar nga prokurori, nga ku do të konkludohet edhe për pretendimet e parashtruara në ankesë.

280.Ankesa është marrë në shqyrtim nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Shqipërisë. Në datën 4.11.2011 praktika i ka kaluar Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale. Nga ana e kësaj drejtorie nuk rezulton t’i jetë kthyer përgjigje ankuesit.

281.Lidhur me këtë ankesë, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në përgjigje të së cilit ka sqaruar se: *“Nuk kam dijeni që ndaj meje të jetë nisur ndonjë procedim disiplinor, i jam drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesën nr. *** prot., datë 6.8.2021, dhe në përgjigjen e ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, me nr. *** datë 12.8.2021, janë vënë në dijeni se në arkivin e tyre rezulton një informacion i Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, që bën fjalë për procedimin penal nr. ***, të vitit 2010. Informacioni i dërguar nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan është i datës 23.11.2011, ndërsa unë jam zëvendësuar nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal nga Drejtuesi Prokurorisë me datë 11.5.2011, me prokuroren E.T., pa i dhënë një zgjidhje përfundimtare çështjes. Vendimi i zëvendësimit të prokurorit, datë 11.5.2011, nuk i është njoftuar ankuesit R.Sh., i cili ka vazhduar ankimet e tij edhe pas datës 11.5.2011, në drejtimin tim, ndërkohë që çështja ka qenë në hetim nga prokurorja E.T.”⁷⁸”.*

282.Sektori i protokoll - arkivit në prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 24.8.2020, ka bërë me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe

⁷⁸Ankuesi R.Sh. ka kërkuar me çdo kusht dënimin e autorit të dyshuar K.Sh., duke iu drejtuar me ankesa, përveç prokurorisë, të gjithë institucioneve të shtetit shqiptar (nuk e di për të huaj). Siç ka rezultuar më vonë në vendimmarrjet e prokurorëve të tjerë, provat shkencore përjashtojnë shkencërisht shtetasin e dyshuar K.Sh., si autor i veprës penale dhe akuza në ngarkim të tij është pushuar. Në datën 8.7.2011 prokurorja E.T. ka vendosur “Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit K.Sh.”, pasi sipas provës shkencore të ADN-së (aktekspertimit biologjik nr. ***, datë 25.4.2011, profili gjenetik i shtetasit K.Sh. nuk është i përfshirë në profilin gjenetik mik të gjetur në provat materiale, në momentin e ngjarjes (spermës së gjetur tek e dëmtuara).

procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit Binas Nina.

283. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2020, ka informuar se ndaj shtetasit Binas Nina në prokurori është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit⁷⁹.

C/3. Rivlerësimi i aftësisë profesionale nga Komisioni

284. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar informacionet e marra nga organet kompetente, denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar materialet e dosjeve profesionale, të administruara për këtë qëllim.

LIDHUR ME KONFLIKTIN E INTERESIT

285. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021, iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me çdo lloj çështjeje penale të shqyrtuar nga kjo prokurori dhe nga subjekti i rivlerësimit Binas Nina, nga fillimi i detyrës e në vijim në lidhje me shtetasit⁸⁰ e përmendur në këtë shkresë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2021, ka informuar se nga verifikimi ka rezultuar si vijon:

286. Për shoqërinë “****” sh.p.k., me administrator A.G., rezultojnë të jenë regjistruar materiali i datës 27.2.2004, për të cilin është vendosur mosfillim me datë 12.3.2004; është regjistruar materiali hetimor nr. ***, datë 9.6.2006, për të cilin është vendosur në datën 16.6.2006 mosfillimi; është regjistruar procedimi penal nr. *** i viti 2015 për nenin 18 të Kodit Penal, procedim i cili është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me dy të pandehur, shtetasin A.G. dhe shoqërinë “****” sh.p.k. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2018, ka vendosur të deklarojë të dy të pandehurit të pafajshëm.

287. Për subjektin “****” sh.p.k. rezulton të jetë regjistruar materiali hetimor datë 26.11.2003, për të cilin është vendosur mosfillimi në datën 9.12.2003 dhe për shtetasin A.G. me procedimin penal nr. ***, të vitit 2016 është vendosur pushimi në datën 29.12.2016.

288. Për shtetasin E.K., materiali hetimor nr. ***, është vendosur “Mosfillimi në datën 26.9.2018⁸¹”.

289. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 18.5.2021, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar asnjë nga materialet kallëzuese apo procedimet penale të përmendura më sipër, si dhe se nuk rezulton të jetë

⁷⁹Në Prokurorinë e Krimeve të Rënda është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 16.9.2019, i shtetasit R.B., i cili ka pretenduar për shpërdorim detyre nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁸⁰Shtetasit A.G. dhe A.G., identifikuar si pala shitëse dhe përfaqësues të shoqërive “****” dhe “****” sh.p.k.; shtetasit P.S., M.S., M.C., L.C., N. D., E. K., identifikuar si shtetasi i cili ka dhënë dëmshpërblimin subjektit të rivlerësimit në masën 1.000.000 lekë; shtetasit L.K., A.B., D.K., I.K., A.B.

⁸¹Nga kallëzimi penal i sipërcituar rezulton se shtetasi E.K. jeton më qira në pallatin nr. *** dhe se ka pasur në përdorim këtë banesë në të cilën ka jetuar për disa vite, ku ka deklaruar se ka pasur probleme me pronarin e pallatit, pasi nuk i është dhënë hipoteka, e për pasojë hyrja është bllokuar nga banka.

regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penale për shtetasit e tjerë të përmendur në këtë shkresë.

290. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka dijeni të këtë konflikt interesi me shoqërinë “****” sh.a. apo ortakët e saj, si dhe me shtetasen N.M., por nuk ka shoqëruar me dokumentacion përkatës.

DENONCIME NGA PUBLIKU

291. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, deri në këtë fazë të hetimit, janë paraqitur nga publiku 2 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit Binas Nina. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar si vijon:

292. **Denoncim nr. *** prot., datë 6.9.2019, e shtetasit R.B.** Ky shtetas ka paraqitur ankesën e tij në disa institucione, duke u ankuar për veprimet dhe mosveprimet e prokurorëve, ndërmjet tyre edhe të subjektit Binas Nina, i cili është caktuar për kryerjen e veprimeve hetimore në datën 20.3.2019, pas zëvendësimit të prokurores P.S. Ankesa është shqyrtuar edhe më parë, pasi ky shtetas ka ngritur një padi në prokurori, material i trajtuar më sipër në kapitullin “Të dhëna nga burimeve të tjera arkivore”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi në denoncim nuk përshkruhen shkelje procedurale që lidhen me subjektin e rivlerësimit, kryesisht denoncimi përmend edhe subjekte të tjera.

293. **Denoncimi nr. ***, datë 16.1.2018, i shtetasit F.H.** Në ankesën e tij ky shtetas drejtohet kundrejt disa zyrtarëve të institucione të ndryshme, por nuk ka asnjë informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit Binas Nina. Nuk janë konstatuar *indicie* apo elemente për thellimin e hetimit mbi këtë denoncim.

DENONCIME MEDIATIKE

294. Nga informacionet e medias publike, subjekti i rivlerësimit Binas Nina përmendet për çështjet penale të paraqitura në mediat *online*: <https://shqiptarja.com/lajm/njerezit-e-drejtisesiqe-po-falin-kamikazet-rruges-binas-nina-e-miranda-konica-vetem-4-vite-burg-per-behar-pemen-ge-vrau-dy-vajza-ne-2020-albert-meca-liroi-jehon-brecanin>, <https://sot.com.al/aktualitet/skandal-n%C3%AB-elbasan-ja-si-i-manipulon-provat-e-aksidentit-prokuroria-stop>.

295. Nga sa më sipër, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2021, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për vënien në dispozicion të vendimeve dhe dokumentacionit përkatës, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2021, vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës, ku nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se:

296. Në lidhje me denoncimin në median *online*: <https://shqiptarja.com/lajm/njerezit-e-drejtisesiqe-po-falin-kamikazet-rruges-binas-nina-e-miranda-konica-vetem-4-vite-burg-per-behar-pemen-ge-vrau-dy-vajza-ne-2020-albert-meca-liroi-jehon-brecanin>. Në denoncimin e lartpërmendur për aksidentin e ndodhur me pasojë vdekjen e dy vajzave dhe plagosje, përshkruhet se: “M.K. është gjyqtarja e Elbasanit, e cila, me kërkesë të prokurorit Binas Nina,

ka dënuar sot me vetëm 4 vite burg B.P., i cili pasditen e 13 shtatorit 2020, në dalje të tunelit të Elbasanit, vrau dy vajzat L.G. dhe Xh. Q., 19 dhe 18 vjeç, duke goditur nga pas makinën e tyre”.

297. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga gjykata rezultoi se, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që i përket çështjes penale me të pandehur Behar Pema, janë bashkëlidhur konkluzionet përfundimtare, si dhe deklaratat noteriale të familjarëve të palëve të dëmtuara. Sa i përket kërkesave të prokurorit të çështjes në gjykim, ato janë parashtruar verbalisht gjatë seancës dhe jo me shkrim. Referuar deklaratave noteriale, datë 31.5.2021, të shtetasve S.Q., E.Q. dhe D.Q., të cilët kanë deklaruar se: *“Në datën 13.9.2020, në aksidentin e ndodhur në aksin automobilistik rrugor Tiranë-Elbasan, kanë gjetur vdekjen e ndjera Gj.E.Q. dhe L.G. dhe kanë mbetur të dëmtuara shtetaset D.D. dhe N.G., ngjarje për të cilën është proceduar shtetasi B.P. Ato kanë deklaruar se: si familjarë të të ndjerës Gj.E.Q. deklarojmë se kemi normalizuar marrëdhëniet familjare me shkaktarin e aksidentit B.P. dhe me familjarët e tij. Nuk ushqejmë asnjë ndjenjë hasmërie dhe sa i përket këtij aksidenti e lëmë në vlerësim të gjykatës”*; deklarata noteriale nr. ***, datë 15.6.2021, e shtetasit E.I.; deklarata noteriale nr. ***, datë 3.6.2021, të shtetasve A., R. dhe N.G.; si dhe deklarata noteriale nr. ***, datë 31.5.2021, e shtetasës D.D., të cilët, gjithashtu, deklarojnë normalizimin e marrëdhënieve, provë në dosjen gjyqësore.

298. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 8.7.2021, rezulton se prokurori Binas Nina ka paraqitur verbalisht diskutimin e tij përfundimtar, ku, veç të tjerash, ka kërkuar: *“Deklarimin fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 290/4, dënimin e tij me 5 vjet burg, deklarin fajtor për drejtimin e mjetit në gjendje të dehur dhe dënimin me 1 vit burg, në aplikim të nenit 55, bashkimin e dënimeve me 6 vite burgim, si dhe aplikimin e pjesës së mbetur dhe vënien në provë për një periudhë 4 vjetësh me qëllim që mos të kryejë vepër tjetër penale”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 8.7.2021, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit B.P. dhe dënimin e tij përfundimisht me 4 vite burgim në një burg të sigurisë së zakonshme, si dhe dhënien e dënimit plotësues për ndalimin e drejtimit të automjetit për një periudhë prej 2 vjetësh, afat i cili fillon nga dita e përfundimit të vuajtjes së dënimit”*. Konstatohet se deklaratat noteriale të nënshkruara nga familjarët e viktimave, të cilat janë referuar edhe në denoncimin mediatik, janë hartuar në zbatim të gurmës “e”, të nenit 48 dhe nenit 49 të Kodit Penal, të cilët vullnetarisht kanë deklaruar se kanë normalizuar marrëdhëniet me shkaktarin e aksidentit dhe familjarët e tij, rrethanë lehtësuese e cila, së bashku me kërkesa të tjera të parashtruara në gjykim, është bërë pjesë e kërkesës së prokurorit, duke kërkuar për të pandehurin dënimin minimal për veprën penale të parashikuar nga pika 4 e nenit 290, të Kodit Penal, e cila parashikon: *“[...] ku vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet”*.

299. Në prapësimet e sjella, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“[...] ndërmjet palëve ka pasur normalizim marrëdhëniesh, e provuar me deklaratë noteriale dhe e shprehur përpara gjykatës. Pas dhënies se vendimit gjyqësor, duke qenë se pati reagim nga palët, çfarë indirekt nënkuptonte që marrëdhëniet nuk ishin normalizuar, kam bërë ankim ndaj këtij vendimi. Çështja penale është në gjykatën e apelit, fakti që ndaj kësaj çështjeje është ushtruar ankim gjen pasqyrim edhe në përmbajtje të vendimit gjyqësor. Pas bërjes së ankimit janë depozituar*

dy deklarata normalizim marrëdhëniesh, ku prokurorit i kërkohet heqje dorë nga ankimi”. Subjekti ka vënë në dispozicion ankimin për vendimin nr. ***, datë 8.7.2021, i cili ka deklaruar fajtor shtetasin B.P., duke parashtruar se familjarët e viktimave kanë shfaqur kundërshtime në lidhje me normalizimin e marrëdhënies dhe se kjo rrethanë është marrë parasysh nga prokurori, në këto kushte, ai ka kërkuar *ndryshimin e vendimit nr. *** të datës 8.7.2021, sa i përket masës së dënimit dhe ashpërsimin e saj.*

300. Nga prapësimet dhe shpjegimet e dhëna, duket se rezultatet e arritura edhe pas shpjegimeve dhe dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit, nuk ndryshojnë, për aq kohë sa prokurori ka kërkuar për të pandehurin B.P. dënimin minimal për veprën penale, të parashikuar nga pika 4 e nenit 290, të Kodit Penal, e cila parashikon: “[...] *ku vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet”.*
301. Gjithashtu, referuar nenit 48 të Kodit Penal, rrethana lehtësuese të cilat lehtësojnë dënimin janë rrethanat, ndër të tjera, germa “e”: *“Kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar”,* rrethanë kjo që edhe në vendimin e gjykatës duket se është çmuar si rrethanë lehtësuese, veç të tjerash, edhe normalizimin e marrëdhënies midis të pandehurit dhe viktimave, bazuar në deklaratat noteriale, nga ku rezulton se (familjarët) janë shprehur për normalizimin e marrëdhënies. Më tej, ashtu sikurse relatohet edhe në ankimin e paraqitur nga prokurori, kanë qenë kundërshtimet e familjarëve, gjatë hetimit dhe në gjykim, që kanë ndryshuar rrethanat për masën e dënimit, duke kërkuar përpara Gjykatës së Apelit Durrës ndryshimin e vendimit në lidhje me masën e dënimit dhe ashpërsimin e dënimit ndaj tij.
302. Në lidhje me denoncimin në median online: <https://sot.com.al/aktualitet/skandal-n%C3%AB-elbasan-ja-si-i-manipulon-provat-e-aksidentit-prokuroria-stop>
303. Denoncimi mediatik: <https://sot.com.al/aktualitet/skandal-n%C3%AB-elbasan-ja-si-i-manipulon-provat-e-aksidentit-prokuroria-stop>. Lidhur me çështjen që i përket palëve ndërgjyqëse L.Q., i cili në denoncimin e tij mediatik ka parashtruar se: *“Pas veprimeve të para, prokuroria nisi hetimet, por në mënyrë të dyshimtë, prokurori i çështjes Binas Nina mbylli çështjen. Dokumentet e siguruar nga ‘STOP’ nxjerrin në pah një sërë parregullsish. Eksperti i parë nxori fajtor shoferin e automjetit tip ‘Ford Fokus’, por prokurori mori për bazë konkluzionin e një tjetër eksperti të pajtuar nga shoferi fajtor. Në morinë e parregullsive rezulton edhe se automjeti ‘Ford Fokus’ nuk kishte pasur as siguracion dhe as kolaudim në kohën e aksidentit. Shkeljet i argumenton edhe eksperti i pavarur F.H.”.*
304. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka dërguar pranë Gjykatës së Lartë vendimin nr. ***, datë 6.2.2016, me kërkues shtetasin L.Q., person i interesuar O.M., me objekt “kundërshtimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Nga shqyrtimi i vendimit rezulton të jetë përshkruar në këtë vendim se: *“Në dosjen e prokurorit ndodhen 2 aktekspertime, që kanë konkluzione të kundërta dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka çmuar se: ‘Prokurori, para se të merrte një vendim, duhet të kryente një aktekspertimi të ri me grup ekspertësh të cilët do të merrnin parasysh pretendimet e të dy palëve dhe aktet e tjera të dosjes do të dilnin në një konkluzion më të saktë shkencor. Kryerja e një akti të ri ekspertimi nuk mund të vendoset nga gjykata, pas gjykata nuk mund të vendosë për marrjen e provave”,*

dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së ankuesit L.Q., prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 20146, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vazhdimin e hetimeve”*. Me tej, ka rezultuar se vendimi është ankimuar nga shtetasi O.M. në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. *** (***), datë 10.7.2017, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e kërkesës së shtetasit L.Q.”*.

305. Nga analizimi i vendimit të sipërpërmendur konstatohet se ekzistojnë 2 aktekspertime: ai i datës 7.9.2016, nga ku rezulton fajtor shtetasi O.M.; dhe aktekspertimit auto-teknik i datës 28.9.2016, i cili ka përcaktuar si shkelës të rregullave të qarkullimit rrugor kryesisht shtetasin L.Q. dhe shtetasin O.M. si të pakujdesshëm, të cilat janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor, mbi bazën e të cilave duket se prokurori, bazuar në pikën 2 të nenit 327 dhe në germën “b”, të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016.

306. Në rezultatet e arritura dhe të dërguara subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se: *“Konstatohet se ekzistojnë 2 akte ekspertimi: ai i datës 7.9.2016, nga ku rezulton fajtor shtetasi O.M.; dhe aktekspertimi auto-teknik i datës 28.9.2016, i cili ka përcaktuar si shkelës të rregullave të qarkullimit rrugor kryesisht shtetasin L.Q. dhe shtetasin O.M. si të pakujdesshëm, të cilat janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor, mbi bazën e të cilave duket se prokurori, bazuar në pikën 2, të nenit 327 dhe germën “b”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016”*.

307. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dërguara, ka shpjeguar se: *“Edhe pse kishte një mendim shkencor nga akti i parë i ekspertimit auto-teknik, për të shuar të gjitha pretendimet e palëve, kam marrë vendim për kryerje riekspertimi. Duke qenë se konkluzioni shkencor në lidhje me pasojën e ardhur ishte definitiv, përtej çdo dyshimi, ‘plagosje e lehtë’, në respektim të përmbajtjes së nenit 290 të Kodit Penal, nuk plotësoheshin elementet e veprës penale, ana objektive saj, pasi mungonte pasoja e kërkuar nga kjo vepër penale. Duke qenë se fakti nuk përbënte vepër penale, hetimet nuk mund të vazhdonin, pasi do të kishim të bënim me ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të paligjshme”*. Në lidhje me zgjidhjen e pasojave administrative, personat e interesuar duhet t’i drejtoheshin gjykatës. Vendimmarrja e prokurorit është e drejtë dhe ky fakt provohet me vendimin nr. *** (***), datë 10.7.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës, ku është vendosur ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 6.2.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e kërkesës kundër vendimit të prokurorisë. Subjekti ka vënë në dispozicioni vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës.

308. Komisioni, në analizë tërësore të shpjegimeve të dhëna, dokumentacionit të administruar, lidhur me sa parashtrohet në denoncimin publik, nisur edhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, i cili ka vlerësuar të drejtë vendimin e prokurorit Binas Nina (të marrë në zbatim të ligjit procedural penal, neni 320/1 dhe germa ‘b’ e nenit 328/1 e vijues të Kodit Penal dhe në zbatim të nenit 290/1, duke vlerësuar faktin se nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi pasoja e ardhur në rastin konkret është “plagosje e lehtë” dhe se nuk plotësohen elementet e pasojës që kërkon vepra penale e parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal), vlerësohet se pretendimi i ngritur, nga sa më sipër, është konstatuar në denoncim mediatik, nuk qëndron.

Kësisoj, shpjegimet e subjektit lidhur me sa më sipër vlerësohen bindëse dhe nuk konstatohen shkelje apo favorizime nga ana e tij për personin e dyshuar.

309. Në konkluzion, dhe duke e parë në tërësi procesin e rivlerësimit të zhvilluar ndaj subjektit rivlerësimit Binas Nina, trupi gjykues çmon se:

- a- Në lidhje me kriterin e pasurisë, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer deklarime të pamjaftueshme, që klasifikohen në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur në nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe të deklarimit të pasurisë dhe nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- b- Në lidhje me kontrollin e figurës, nuk janë konstatuar elemente bindëse që të provonin ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme dhe nisur edhe nga deklarimi i saktë i subjektit në deklaratën për kontrollin e figurës, trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk gjen zbatim pika 2 e nenit 61.
- c- Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa më sipër, trupi gjykues çmon se z. Binas Nina ka arritur një nivel kualifikues, sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.
- d- Gjithashtu, trupi gjykues çmon se disa nga problematikat e konstatuara në kriteret e vlerësimit të lartpërshkruara – të cilat, ndonëse nuk mjaftonin në vetvete për aplikimin e ndonjë mase specifike lidhur me kriterin në të cilin janë evidentuar – parë në tërësinë e tyre, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, duhet të aplikohet edhe pika 5 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

310. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin tërësor të çështjes, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Binas Nina, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në ligjin nr. 84177, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjekti të rivlerësimit Binas Nina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 16.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi/Ertugena Sokoli